



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare***

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me Prokuroren e Përgjithshme për raportimin e veprimtarisë për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Andi Permeti, Edmond Leka, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Ediola Braho dhe Alban Zeneli.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Alket Hyseni, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Arta Marku – Prokurore e Përgjithshme

Adnand Xholi – Drejtor i Drejtorisë Gjyqësore dhe Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë

Adnand Kosova – Drejtor i Drejtorisë së Studimeve, Inspektimit dhe Çështjeve të tjera ligjore

Thoma Jano – Drejtor i Drejtorisë së Përgjimeve dhe Telekomunikacionit

Luan Abazi – Drejtor i Drejtorisë së Financës

Alketa Zifla – Drejtore Kabineti

Matilda Terpollari – Këshilltare për Median

Gent Onuzaj – Operator

Blreina Fani – Këshilltare Ligjore e OSBE-së

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja - Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjen që kemi sot në rendin e ditës. Përpara se të fillojmë dua të sjell në vëmendjen e kolegëve dhe të opinionit publik që në zbatim të nenit 37 të Rregullores së Kuvendit, kjo seancë dëgjimore organizohet në bashkëpunim me Komisionin e Sigurisë, pra është një mbledhje e përbashkët e dy komisioneve, e Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Komisionit të Sigurisë.

Në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore me Prokuroren e Përgjithshme për veprimtarinë e institucionit që ajo drejton, për vitin 2018. Raporti i veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme u është shpërndarë kolegëve deputetë, por ka edhe një material nga Shërbimi i Monitorimit të institucioneve të pavarura në Kuvendin e Shqipërisë ka një material përmbledhës për këtë raport. Relatore është kolegja Vasilika Hysi, ndërsa mbledhjen e përbashkët do ta drejtojmë unë dhe kolegja Felaj, si kryetare e Komisionit të Sigurisë.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Prokuroria e Përgjithshme, zonja Arta Marku, Prokurore e Përgjithshme, zoti Adnan Xholi, drejtor i Drejtorisë Gjyqësore dhe i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, zoti Adnan Kosova, drejtor i Drejtorisë së Studimeve, Inspektimit dhe çështjeve të tjera ligjore, zoti Thoma Jano, drejtor i Drejtorisë së Përgjimeve dhe Telekomunikacionit, zoti Luan Abazi, drejtor i Financës pranë këtij institucioni, si dhe stafi i kabinetit që e shoqëron prokuroren në këtë seancë dëgjimore.

Po ashtu nga OSBE-së e pranishme është zonja Blerina Fani, këshilltare ligjore.

Zonja Prokurore, mirë se keni ardhur në këtë seancë dëgjimore!

Siç ju është bërë e ditur paraprakisht, edhe sipas manualit që Kuvendi ka miratuar për raportimin e institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, do të keni në dispozicionin tuaj 20 minuta për të na bërë një prezantim të veprimtarisë së institucionit që ju drejtoni, për vitin 2018. Natyrisht, është në interesin e kolegëve të të dy komisioneve që ju të fokusoheni te përmbushja e rekomandimeve që Kuvendi ka lënë për institucionin që ju drejtoni për vitin 2018, me qëllim që t'ju lëmë më shumë kohë kolegëve deputetë për pyetjet që ata kanë, kjo edhe për shkak të interesimit nga ana e tyre.

Do t'u kërkoja kolegëve që ne paraprakisht të kemi një kohë të dakordësuar që të mos ta humbasë rëndësinë kjo seancë dakordësimi, por, gjithsesi, kur të kalojmë në fazën e pyetjeve dhe të diskutimeve, të kemi një minutazh të përcaktuar paraprakisht për secilin nga kolegët.

Pa humbur kohë nëse nuk ka ndonjë gjë për të shtuar kolegja Felaj, po ia kaloj fjalën zonjës Marku, për të filluar me raportimin.

Fjala për ju, zonja Prokurore.

Arta Marku – Faleminderit!

Të nderuar kryetarë të komisioneve,

Të nderuar deputetë,

Ky është raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit paraqitet në përmbushje të detyrimit të parashikuar nga neni 148/b, shkronja “d” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, i ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Prokuroria ka ushtruar kompetencat e saj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ligje të tjera në fuqi, si dhe Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit European, prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit dhe strategjinë afatmesme të prokurorisë për vitet 2018-2020.

Po filloj shkurtimisht me treguesit statistikorë të punës.

Gjatë vitit 2018 në organin e prokurorisë janë trajtuar 57 734 materiale kallëzuese, që përbëjnë një ulje prej 0,96 % në krahasim me vitin 2017. Janë ndjekur gjithsej 42 814 procedime penale, që përbëjnë një rritje prej rreth 5% në krahasim me vitin 2017.

Nga këto, 31 409 janë procedime penale të regjistruara të reja, 486 procedime penale janë të rifilluara për vitin 2018 dhe janë mbartur nga viti 2017, 10 919 procedime.

Është vendosur mosfillimi për 14 920 referime dhe kallëzime penale në krahasim me 17 378 mosfillime për vitin 2017, pra ka një ulje të numrit të mosfillimeve të kallëzimeve penale.

Janë regjistruar kryesisht 109 procedime penale nga ana e prokurorisë, në krahasim me 148 procedime të regjistruara kryesisht një vit më parë. Pavarësisht se ka një rënie të numrit të çështjeve të filluara kryesisht, por duhet theksuar se ky numër nuk është i ulët dhe në asnjë mënyrë nuk është i papërfillshëm.

Së pari, fillimi i çështjeve kryesisht është një atribut i prokurorit dhe pas reformës në drejtësi, jo më vetëm i drejtuesit apo i Prokurorit të Përgjithshëm aq më pak, por është atribut i çdo prokurori.

Së dyti, nuk ka një parashikim ligjor që vendos një lloj niveli apo raporti që duhet të kenë procedimet e filluara kryesisht me ato të filluara nëpërmjet referimeve.

Së treti, viti 2018 ka qenë një vit jo i zakonshëm për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët, sepse filloi procesi i vetingut. Shumë prokurorë kanë qenë gjatë gjithë kohës në korrespondencë

me KPK-në dhe në kontakt të vazhdueshëm me të, nëpërmjet pyetësorëve. Janë bërë shumë shkarkime prokurorësh, kjo do të thotë se prokurorët kanë qenë pak apatik, pasi në mënyrë të pashmangshme ky proces ka ndikuar negativisht te ta, duke i bërë edhe të pasigurt. Pavarësisht gjithë kësaj, të gjithë kemi folur shumë për këtë gjë dhe kemi rënë dakord që reforma duhej dhe në këtë mënyrë vetingu ishte i pashmangshëm, kështu që pasojat te prokurorët janë këto.

Në përmbledhje të këtyre treguesve, do të thosha se ka një ulje të lehtë të numrit total të materialeve që ka trajtuar prokuroria shqiptare. Ky është një tregues për ngarkesën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ulja e lehtë e këtij treguesi nuk mund të lexohet në asnjë mënyrë si një rënie e treguesve të punës së prokurorisë. Prokuroria është një institucion që nuk funksionon i vetëm dhe për nga mënyra sesi funksionon vetëm një numër i ulët i çështjeve mund të jenë të regjistruara me iniciativën e saj, pjesa tjetër janë produkt i referimeve nga policia e shtetit, qytetarët, institucionet e ndryshme dhe nëse referimet dhe kallëzimet kanë qenë në masë pak më të vogël, kjo nuk mund t'i faturohet vetëm prokurorisë.

Numrin më të madh të procedimeve e ka regjistruar Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me 31% të numrit total të procedimeve të regjistruara në shkallë vendi.

Prokuroritë e tjera me ngarkesën më të lartë janë Prokuroria e Shkallës së Parë Durrës, prokuroritë e Shkallës së Parë Elbasan dhe Shkodër me pak a shumë të njëjtin numër procedimesh dhe prokuroritë e tjera me radhë.

Përqindja më e ulët e kriminalitetit për 100 000 banorë, vërehet në qarkun Dibër, ndërsa përqindja më e lartë në qarkun Vlorë njësoj si një vit më parë.

Sa i përket tendencës së kriminalitetit, vërehet se rritjen më të lartë për vitin 2018 e kanë qarku Durrës dhe qarku Fier, ndërsa ulje të kriminalitetit ka pasur në qarqet Kukës, Gjirokastrë dhe Berat.

Sa i përket raportit mes krimeve dhe kundërvajtjeve penale, bazuar në statistikat e vitit 2018, rezulton se 83% e procedimeve penale u përkasin krimeve dhe pjesa tjetër janë kundërvajtje.

Sa i përket raportit të grupveprave, sipas strukturës së Kodit Penal me numrin total të procedimeve, ndër grupveprat penale me numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara nga ana e prokurorisë janë vjedhja e pasurisë që përbën numrin më të lartë me 34 % të numrit të përgjithshëm të çështjeve penale; veprat kundër rendit dhe sigurisë publike, që përbëjnë 24 % të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale dhe që kanë një rritje krahasuar me vitin 2017; veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës, që kanë 5% të numrit të përgjithshëm të çështjeve, por me një ulje prej 29% në krahasim me vitin 2017; veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, me 4%, edhe këto paraqesin një ulje prej 8% krahasuar me vitin 2017;

veprat penale kundër sekretit dhe kufijve me 4 % dhe kanë një rritje të theksuar në krahasim me vitin 2017; si edhe falsifikimi i dokumenteve dhe vepra të tjera.

Efikasiteti në veprën penale.

Gjatë vitit 2018 janë përfunduar 30615 çështje (në vitin 2017 janë përfunduar 30036 çështje). 38,5 % e çështjeve janë dërguar për gjykim (rritje e konsiderueshme e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim), 21,7 % janë pushuar (rritje e lehtë krahasuar me vitin 2017), 35,6 % janë pezulluar (ka një rënie të numrit të procedimeve të pezulluara krahasuar me vitin 2017) dhe 4,2 % janë transferuar në prokurorinë kompetente.

Konkretisht në vitin 2018 janë dërguar në gjykatë 11790 çështje (në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë 11492 çështje) me akuzë ndaj 13403 të pandehurve (në vitin 2017 janë dërguar për gjykim 12808 të pandehur). Krahasimisht me vitin 2017 rezulton një rritje prej 2,59 % e numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë dhe 4,65 % e numrit të të pandehurve dërguar në gjykatë.

Në lidhje me vendimet e gjykatës, nga të dhënat statistikore rezulton se në vitin 2018 janë dënuar 10246 të pandehur dhe për 211 të pandehur është dhënë vendim për deklarimin të pafajshëm. Në vitin 2017 janë dhënë vendime pafajësie për 338 të pandehur, ndërkohë në gjykim kanë qenë dërguar 12808 të pandehur.

Gjatë vitit 2018 është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë për 315 çështje me 318 të pandehur; i janë dërguar gjykatës 591 kërkesa për miratim të urdhrit penal në lidhje me 619 të pandehur dhe në 43 raste është vendosur refuzimi i miratimit të urdhrit penal. Në vitin 2017 janë dërguar 255 kërkesa për miratim të urdhrit penal dhe 29 janë refuzuar nga gjykata; i janë dërguar gjykatës 570 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë në lidhje me 621 të pandehur dhe në 38 raste është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes. Në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë 356 kërkesa për miratim të marrëveshjes së fajësisë dhe në 10 raste është vendosur refuzimi i miratimit të marrëveshjes.

Gjatë vitit 2018, u dërguan në gjykatë për pushim 2605 çështje. Nga të dhënat rezulton se për 169 çështje gjykata vendosi kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve ndërsa në 12 çështje vendosi kthimin e akteve dhe urdhërimin e formulimit të akuzës. Në vitin 2017 janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim 1371 çështje, në 27 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve. Në 4 çështje është vendosur kthimi i akteve dhe formulimi i akuzës.

Rezoluta e Kuvendit dhe mënyra si ajo është zbatuar.

Në përfundim të raportimit të veprimtarisë së Prokurorisë për vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë duke vlerësuar veprimtarinë e Prokurorisë për vitin e raportimit dhe duke i përcaktuar prokurorisë disa detyra për vitin 2018.

Sipas rezolutës, Kuvendi i ka kërkuar Prokurorisë që për vitin 2018 të realizojë:

Rritjen e numrit të hetimeve në tërësi dhe në veçanti të hetimeve proaktive kundër krimit të organizuar, korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë dhe të mesëm, funksionarëve të sistemit të drejtësisë, të zgjedhurve në nivel qendror dhe vendor.

Lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar, trafikëve e krimeve të tjera të rënda, edhe për vitin 2018 ka qenë prioritet i aktivitetit tonë institucional. Për arritjen e rezultateve ndaj tyre, objektiv i rëndësishëm yni ka qenë forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me autoritetet vendase dhe të huaja, si në nivel operacional, ashtu dhe nëpërmjet trajtimit dhe përgjigjes në kohë e në mënyrë efikase të letër kërkesave të autoriteteve të huaja.

Në funksion të zbatimit të planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr.1, datë 20.02.2018 “Për krijimin e seksioneve të posaçme”, në PKR dhe disa prokurori të tjera. Efekti i këtij udhëzimi dhe i seksioneve të krijuara do të pasqyrohet në vazhdim për një kategori veprash penale që lidhen me krimin e organizuar.

Sipas të dhënave statistikore, evidentohet se ka një ulje prej 37 % të numrit në total të procedimeve të regjistruara për veprat penale të korrupsionit. Numrin më të lartë në procedimet e regjistruara për veprat penale të korrupsionit për vitin 2018 e zë vepra penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, e konkretisht në masën 43 % të tyre, ndërsa për vitin 2017 kjo vepër përbënte 22 % të totalit të procedimeve për korrupsion. Procedimet e regjistruara për këtë vepër janë rritur nga 61 procedime në vitin 2017, në 74 procedime në vitin 2018 ose me rritje 21 % të procedimeve të regjistruara.

Në lidhje me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, treguesit janë pothuajse të njëjtë me vitin 2017: 24 çështje të regjistruara për vitin 2017 dhe 23 çështje të regjistruara për vitin 2018.

Në lidhje me korrupsionin në sistemin e drejtësisë, gjatë vitit 2018 janë regjistruar 3 procedime penale për nenin 319 të Kodit Penal dhe 29 procedime penale janë regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, ndërsa 2 procedime për këtë vepër janë dërguar për gjykim. Ndërsa në vitin 2017 për veprën penale të parashikuar nga neni 319 i Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 1 procedim penal dhe për veprën penale të parashikuar në

nenin 319/ç të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe zyrtarëve të tjerë të drejtësisë”, prokuroria ka regjistruar 14 procedime penale, ndërkohë 1 çështje penale është dërguar në gjykatë.

Për veprat penale të korrupsionit aktiv e pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, gjatë vitit 2018 janë regjistruar 3 procedime sipas nenit 245, njësoj me vitin 2017, si dhe 6 procedime sipas nenin 260, kundrejt 13 procedimeve të regjistruara në vitin 2017. Shihet që ka një ulje të lehtë të treguesve.

Përsa i përket korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, vepër e parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, për vitin 2018 janë regjistruar 29 procedime (24 në gjykim) kundrejt 124 procedimeve të regjistruara një vit më parë .

Duke i analizuar këta tregues objektivisht, mund të themi që është ulur numri i çështjeve të regjistruara krahasuar me një vit më parë, por për korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë dhe për korrupsionin e funksionarëve të drejtësisë është rritur numri i çështjeve në hetim dhe ai i çështjeve të dërguara për gjykim.

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga rezoluta, lidhur me rritjen e hetimeve proaktive për veprat penale kundër korrupsionit, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 93 procedimeve penale, ndërkohë 30 procedime i përkasin Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 63 procedime u përkasin prokurorive të tjera, krahasuar me vitin 2017 me shifra në rritje 14,4 %. Kjo veprimtari ka shërbyer në ndalimin e 73 personave të arrestuar në flagrancë apo ndaluar si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale të korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, ndërkohë 14 persona/autorë të dyshuar i përkasin kompetencës të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe 59 persona/autorë të dyshuar në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Ndërkohë, janë filluar kryesisht nga prokuroria 21 çështje për vepra që lidhen me abuzimin me funksionin publik, ku peshën kryesore e përbëjnë procedimet që lidhen me shpërdorimin e detyrës, për të cilën janë filluar kryesisht 8 çështje dhe korrupsioni pasiv i funksionarëve të sistemit të drejtësisë për të cilët janë filluar kryesisht 5 çështje.

Vlen të theksojmë se të gjitha prokuroritë janë njohur me rezolutën e Kuvendit dhe me planin e veprimit të hartuar nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjatë takimeve periodike me drejtuesit e prokurorive dhe gjatë analizave vjetore është bërë prezent gjithmonë mungesa e referimeve nga Policia e Shtetit për këtë vepër penale. Ky problem është diskutuar prej tyre edhe me zyrtarë të policisë nëpër rrethe. Veprat penale të korrupsionit janë të tilla që institucionet duhet të rakordojnë veprimet dhe të bëhet një hetim proaktiv. Nuk mund të hetohet

korupsioni me hetim historik, post faktum, kështu që më duhet t'ju transmetoj shqetësimin e prokurorëve për mungesë të referimeve për këto vepra dhe thjesht këtë po bëj, nuk po ngarkoj me përgjegjësi institucione të tjera, por të gjithë e dimë, se jemi juristë dhe një çështje e suksesshme për vepra të tilla penale nuk mund të bëhet pa një referim të mirë, në kohën e duhur dhe duke përdorur metodat speciale të hetimit. Mesa duket, në hetimin e këtyre veprave, institucionet nuk kanë arritur të kenë sukses të dukshëm. Megjithatë, ky është një problem i njohur dhe kjo ka qenë dhe arsyeja e bërjes së reformës në drejtësi dhe e parashikimit për ngritjen e institucioneve të reja, që do luftojnë këtë fenomen në nivel prokurorie, gjykate dhe policie gjyqësore.

Megjithatë, pavarësisht të gjithave, siç ju referova më lart, ka pasur hetime proaktive, çështje të filluara kryesisht, si dhe përmirësim të treguesve të paktën për dy prej veprave penale kundër korupsionit.

Sa u përket treguesve statistikorë për veprat penale të krimit të organizuar, për vitin 2018 rezulton se janë regjistruar 41 procedime për veprën penale që parashikon neni 333/a, “Grupi i strukturuar kriminal”, ndërkohë 6 procedime penale janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me rritje rreth 2,5 herë të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale. Në vitin 2017, për këtë vepër kanë qenë regjistruar vetëm 16 procedime. Numri i të pandehurve të dënuar për këtë vepër është 51, ndërkohë në vitin 2017 ky numër ishte 30.

Lidhur me trafikun e qenieve njerëzore, në vitin 2018 për veprën penale “Trafikimi i personave të rritur” të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal janë regjistruar 17 procedime penale, ndërkohë, krahasuar me vitin 2017, është ulur me 29 % numri i procedimeve të regjistruara. Edhe për veprën penale “Trafikimi i të miturve” ka një ulje të numrit të çështjeve të regjistruara, krahasuar me një vit më parë.

Sa i përket “Trafikimit të armëve dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/a i Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistruar 11 procedime penale, ndërkohë 3 procedime janë dërguar për gjykim, ose, krahasuar në vitin 2017, kjo shifër është rritur rreth 2 herë të numrit të procedimeve të regjistruara.

Në lidhje me luftën kundër terrorizmit, të dhënat statistikore të vitit 2018 për veprën penale “Financimi i terrorizmit”, të parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal, janë regjistruar 4 procedime penale, ndërkohë që krahasuar me vitin 2017 janë regjistruar 3 procedime penale, pra ka një rritje prej 1 procedimi.

Pika e dytë e rezolutës së Kuvendit ka qenë rritja e numrit të hetimeve proaktive “Për veprat penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, trafikimi i narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike”.

Në zbatim të detyrimit që rrjedh nga rezoluta për rritjen e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e narkotikëve, gjatë vitit 2018 janë kryer hetime proaktive dhe me përdorim të teknikave të posaçme të hetimit në kuadrin e 250 procedimeve penale, ndër këto, 104 procedime i përkasin Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe pjesa tjetër prokurorive të tjera.

Kjo veprimtari ka shërbyer në parandalimin e 275 personave të arrestuar në flagrancë, apo ndaluar si të dyshuar për përfshirjen në kryerjen e veprave penale në fushën e narkotikëve, ndërkohë 151 persona të dyshuar i përkasin kompetencës të prokurorisë për krime të rënda.

Të dhënat statistikore lidhur me veprat penale në fushën e narkotikëve në vitin 2018 tregojnë se, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal janë regjistruar 1127 procedime, ndërkohë **247** procedime janë dërguar në gjykatë ose krahasuar me vitin 2017 me ulje 5,5 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe atyre të dërguara në gjykatë.

Për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, janë regjistruar 292 procedime penale, ndërkohë 46 procedime janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2017 është ulur me 22 % numri i procedimeve të regjistruara dhe atyre të dërguara për gjykim.

Lidhur me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në vitin 2018 janë regjistruar 105 procedime penale, ndërkohë janë dërguar në gjykatë 39 procedime ose krahasuar me vitin 2017, me ulje 46 % të numrit të procedimeve të regjistruara dhe atyre të dërguara për gjykim.

Në përmbyshje të funksioneve kushtetuese e ligjore dhe në zbatim të rezolutës për këtë tregues, e konsiderojmë të zbatuar detyrimin për faktin se në uljen në tërësi të numrit të procedimeve të regjistruara për këto grup veprash, kanë ndikuar si masat e marra në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel qendror dhe vendor në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të narkotikëve, ashtu dhe efektet parandaluese, si nga sekuestrimi i sasive të konsiderueshme të drogës së kultivuar edhe të kapur gjatë vitit 2018, ashtu edhe goditja e vazhdueshme e veprimtarisë kriminale në këtë fushë.

Një tjetër pikë e rëndësishme e rezolutës është “Rritja e numrit të hetimeve pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, mjeteve dhe produkteve të veprave penale me origjinë krimin e organizuar, sipas ligjit antimafia”.

Sa i përket zbatimit të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar”, për vitin 2018 janë trajtuar **774** raste të hetimit pasuror nga të cilët, për 13 referime pasurore është vendosur mosfillimi, ndërsa pjesa tjetër e materialeve pasurore janë mbartur për vitin 2019.

Për vitin 2018, organi i akuzës ka paraqitur në gjykatë 4 kërkesa për konfiskimin e pasurive dhe 7 kërkesa për sekuestrim pasurie. Më duhet t’ju them gjithashtu se në momentin e përpilimit të raportit vjetor prokuroritë e rretheve dhe Prokuroria për Krimet e Rënda nuk kishin dërguar ende informacionin për hetimet pasurore dhe për këtë arsye, duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme është vetëm mbledhëse dhe pasqyruese e të dhënave dhe jo përpunuese e tyre, janë pasqyruar ashtu siç janë sjellë. Gjatë hedhjes së të dhënave është konstatuar se nuk janë të sakta dhe janë rikërkua të detajuara, kështu që treguesit që do t’ju prezantoj nuk përputhen, në fakt, me raportin që mund të keni lexuar, por korrigjimet do t’ju vihen në dispozicion.

Për të orientuar prokurorët në praktikë dhe duke vlerësuar si shumë të rëndësishme veprimtarinë e prokurorisë në drejtim të hetimit pasuror, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr. 6, datë 20.11.2018 “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”. Është mbikëqyrur zbatimi i këtij udhëzimi në praktikë dhe ka rezultuar se si prokuroritë e rretheve ashtu edhe Prokuroria për Krimet e Rënda e kanë zbatuar atë duke përmirësuar ndjeshëm edhe mbajtjen e të dhënave statistikore.

Nga nxjerrja e udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe deri më sot janë regjistruar 162 referime pasurore të reja. Konkretisht, treguesit për hetimet pasurore qoftë të lidhura me procesin penal, qoftë në zbatim të ligjit antimafia, gjatë vitit 2018 e deri aktualisht janë të tillë: janë paraqitur 26 kërkesa për sekuestrim të pasurive si pjesë e procesit penal. Pasuria e sekuestruar është në vlera monetare, apartamente, troje, sipërfaqe tokash, automjete me vlera të konsiderueshme e të tjerë. Në shumë raste pasuria e sekuestruar është vlerësuar, po në disa raste të tjera vlerësimi është ende në proces. Me përafërsi vlera e pasurive të sekuestruara është rreth 3 miliardë lekë, 12 milionë euro, 91 mijë paund, 270 mijë dollarë, 80 mijë franga si dhe qindra hektarë tokë, dhjetëra ndërtesa dhe automjete.

Janë paraqitur gjithashtu 5 kërkesa për konfiskim pasurie në funksion të procedimit penal. Pasuritë e konfiskuara janë: troje, ndërtesa dhe qindra hektarë tokë, por nuk ka një vlerësim në vlerë monetare që t’ju jap një shifër.

2 kërkesa për konfiskim pasurish janë paraqitur sipas ligjit antimafia nga Prokuroria për Krimet e Rënda, të cilat janë në proces vlerësimi dhe konsistojnë në vila, apartamente, automjete si dhe një sasi prej rreth 13 milionë lekësh.

Gjithashtu, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka paraqitur një kërkesë për konfiskim sipas ligjit antimafia, që është ende në proces gjykimi në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Vlera e pasurisë për të cilën është kërkuar konfiskimi është rreth 3 milionë euro.

Një pikë tjetër e rezolutës është “Garantimi i ndihmës në procesin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e reja që priten të krijohen, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në procesin e vlerësimit profesional dhe hetimin disiplinor të prokurorëve”.

Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë pranë gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apeleve janë angazhuar maksimalisht dhe kanë përmbushur detyrimet ligjore për të ndihmuar në përshpejtimin e procesit të rivlerësimit profesional të prokurorëve në kuadër të rivlerësimit kalimtar të tyre.

Duhet theksuar se në të gjitha prokuroritë janë marrë masat e nevojshme për të siguruar/garantuar ndihmën për organet e rivlerësimit nëpërmjet hedhjes së shorteve.

Në vitin 2018 prokurorët e grupit të punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive përkatëse janë angazhuar në procedurën e hedhjes së shorteve nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në përzgjedhjen e çështjeve për vlerësimin profesional të 118 prokurorëve e drejtuesve të prokurorive të niveleve të ndryshme.

Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka dorëzuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit gjithsej 83 raporte të vlerësimit profesional të subjekteve prokuror/drejtues prokurorish. Në dhjetor 2018, me krijimin dhe konstituimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, 35 praktika që ishin ende në proces vlerësimi, iu kaluan Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shkak të kompetencës që ka tashmë ky institucion për të bërë vlerësimin e prokurorëve.

Aktualisht, në procesin e rivlerësimit kalimtar kanë kaluar dhe janë konfirmuar në detyrë 19 prokurorë, ndërsa për 21 prokurorë është vendosur shkarkimi nga detyra, prej të cilëve 15 prokurorë janë të pezulluar në pritje të shqyrtimit të ankimit të tyre në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

Në kuadrin e ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë, siç edhe ka qenë fakti i bërë publik, Prokurori i Përgjithshëm ka marrë të gjitha masat për të zhvilluar mbledhjen e përgjithshme, e cila është zhvilluar dhe procesi i votimit ka rezultuar pa asnjë lloj problematike dhe shumë transparent. Kjo mbledhje u zhvillua në datën 11 dhjetor dhe u zgjodhën 6 anëtarët prokurorë të këshillit. Këshilli tashmë është konstituuar dhe vazhdon punën e tij.

Një pikë tjetër e rezolutës është përdorimi i instituteve procedurale të reja si urdhri penal, marrëveshja e fajësisë, gjykimi i drejtpërdrejtë në mënyrë më efektive për t'i shërbyer shpejtësisë së procesit.

Për zbatimin e instituteve të reja procedurale të miratuar në ligjin nr. 35/2017, të hyra në fuqi në datën 1 gusht 2017, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me OPDAT-in, ka organizuar një takim pune me gjithë drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm me qëllim diskutimin teorik të këtyre instituteve dhe nxitjen e prokurorëve për një aplikim sa më të gjerë të tyre.

Duhet theksuar se krahasuar me një vit më parë treguesit për këto institute të reja procedurale janë përmirësuar ndjeshëm duke u dyfishuar. Janë bërë të gjitha përpjekjet për t'i nxitur prokurorët në përdorimin e tyre.

Kuvendi me rezolutën e tij ka kërkuar që këto institute të përdoren dhe të dhënat tregojnë për një dyfishim të përdorimit të tyre që nuk mund të konsiderohet i papërfillshëm, prokurorët, avokatët mbrojtës, po i njohin gradualisht këto institute dhe po i bëjnë pjesë të praktikës së tyre.

Një pikë tjetër e rezolutës ka qenë forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjzbatuese me qëllim luftën kundër krimit të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave, si dhe marrjen e masave për adresimin e problematikave që konstatohen nga progresraporti i BE-së për Shqipërinë.

Në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë dhe bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve për grupet e strukturuar kriminale Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin nr.2, datë 18.06.2018 me synim për të përmirësuar koordinimin e informacionit dhe ndjekjen e tij në çështjet e ekstradimit për jashtë. Në kuadrin e këtij bashkëpunimi, të dhënat statistikore për periudhën janar - dhjetor 2018, evidentojmë se janë trajtuar 1856 kërkesa nga jashtë dhe për jashtë shtetit, ku përfshihen: ekstradimet, letërporositë, njohjet e vendimeve, transferimet e procedimeve dhe të personave të dënuar. Gjatë vitit 2018 prokuroria, gjithashtu ka shpallur në kërkim ndërkombëtar gjithsej 256 subjekte dhe ka kërkuar që Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana të procedojë për heqjen e 63 subjekteve nga listat e kërkimit ndërkombëtar.

Vlerësojmë të theksojmë se Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, krahas volumit të punës të trajtuar specifikisht sipas fushave të mësipërme gjatë vitit 2018 ka trajtuar në kohë reale edhe 401 kërkesa të ndryshme të ardhura nga autoritetet gjyqësore të huaja.

Më datën 28.04.2018 u nënshkrua një memorandum mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Autoritetit suedez të prokurorisë, ku synohet bashkëpunimi në fushën e drejtësisë penale për të miturit.

Më datën 26.09.2018 u nënshkrua në Sofje, memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Prokurorisë së Republikës së Bullgarisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë. Në maj 2018 Republika e Shqipërisë ka miratuar në parim marrëveshjen e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it. Duke qenë se Prokuroria e Përgjithshme është autoriteti, i cili në bazë të marrëveshjes ka për detyrë zbatimin e saj, theksojmë se janë marrë të gjitha masat për të bërë të mundur fillimin e funksionimit të marrëveshjes. Konkretisht jemi në fazën e koordinimit dhe të bashkëpunimit me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku kemi nënshkruar një marrëveshje dhe jemi duke parë nëpër prokuroritë e rretheve dhe në Prokurorinë e Përgjithshme se si është standardi i ruajtjes dhe i përpunimit të të dhënave personale që është një nga kërkesat kryesore për t'u bërë funksionale marrëveshja.

Ulsi Manja - Zonja, Marku, ju lutem mund ta përmbledhni fjalën!

Arta Marku - Sa kohë më ka mbetur?

Ulsi Manja - Koha ka kaluar, por tani duhet ta përmbyllni fjalën, sepse ka edhe pyetje nga kolegët.

Arta Marku – Patjetër!

Janë nënshkruar 3 marrëveshje për ngritjen e grupeve të përbashkëta hetimore ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë. Gjithashtu është në proces nënshkrimi i një marrëveshje tjetër për ngritjen e një skuadre të përbashkët hetimore me Italinë.

Një nga pikat e tjera të rezolutës është ashpërsimi i politikës penale për masat e sigurisë dhe të dënimit kundër krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje e të tjera.

Prokuroria gjatë vitit 2018, siç e tregojnë edhe të dhënat statistikore ka ndjekur një politikë të ashpër penale për kryerjen e veprave penale të krimit të organizuar, pjesa më e madhe për masa sigurimi kanë qenë për “arrest me burg”, në kërkesat për dënim pjesa më e madhe kanë qenë nën marzhin mesatar të dënimit, kjo është një shifër në rritje krahasuar me vitin 2017.

E njëjta situatë është për veprat penale korruptive, ashpërsimi i masave të sigurimit dhe një tendencë për dënime më të ashpra.

E njëjta situatë është për veprat penale kundër jetës të kryera me dashje dhe për çdo vepër tjetër që ka qenë e parashikuar në rezolutë.

Një problem që është konstatuar dhe është bërë prezent gjatë analizave vjetore të punës së prokurorive, ku të pranishëm kanë qenë edhe drejtues të institucioneve të tjera është pamundësia e aplikimit të masës së sigurimit “arrest në shtëpi” nën mbikëqyrje elektronike për shkak se zyra e Shërbimit të Provës nuk disponon pajisjet për ta bërë këtë masë efektive. Ky lloj i masës së sigurimit është mjaft i rëndë dhe mjaft efektiv, në fakt dhe nuk i detyron prokurorët, gjykatat të aplikojnë “arrest me burg” aty ku nevojat e sigurimit garantohen me “arrestin në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike.

Në Prokurorinë e Tiranës është në hetim një çështje që ka për objekt abuzimet që kanë ndodhur gjatë kryerjes së procedurave për blerjen e pajisjeve për mbikëqyrjen elektronike, por një ligj nuk mund të lihet pa u zbatuar në pritje të përfundimit të një hetimi.

Një pikë tjetër e rezolutës ka qenë ndjekja e një politike penale më të butë ndaj të miturve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara. Për të bërë të mundur zbatimin e kësaj pike të rezolutës Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr.5, datë 26.10.2018 i shoqëruar me modelet e akteve kryesore me një broshurë për të shpjeguar të drejtat që kanë viktimat. Udhëzimi është hartuar me asistencën e OPDAT-it. Duket që ka përmirësuar ndjeshëm mënyrën sesi trajtohen viktimat, qofshin edhe të mitur gjatë procesit penal, që nga fillimi dhe deri në përfundim të tij.

Një pikë tjetër e rezolutës ka qenë thellimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, si edhe institucionet e tjera të pavarura. Prokuroria, si organ kushtetues dhe subjekt i rëndësishëm i sistemit të drejtësisë penale është angazhuar në bashkëpunimin veçanërisht me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Ministrinë e Brendshme në dhënien e kontributit të saj në iniciativat ligjore për përmirësimin e drejtësisë penale, hartimin e dokumenteve strategjike kombëtare dhe raportime për përmbushjen e prioriteteve dhe rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë në kuadër të procesit integruar të vendit. Veçojmë të përmendim këtu, angazhimin tonë në procesin *screening*.

Prokurorë të Prokurorisë të Përgjithshme kanë marrë pjesë në të gjitha grupet e punës për diskutimin e ndryshimeve të ligjeve, siç është ligji “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, si edhe ligje të tjera “Për dhënie amnistie”, “Për Policinë Gjyqësore” e të tjera.

Gjithashtu, në kuadrin e reformës në drejtësi dhe ndryshimeve rrënjësore në sistemin e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë, me synim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me EURALIUS ka ngritur grupe pune të përbashkëta dhe po punohet për rishikimin dhe përgatitjen e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm në funksion të

përmirësimit të veprimtarisë organizative dhe funksionale të Prokurorisë në të gjitha hallkat dhe nivelet e juridiksionit të përgjithshëm, në përjasje edhe me standardet europiane dhe me praktikat më të mira.

Një nga pikat e tjera të rezolutës ka qenë ndjekja në vazhdimësi e rasteve që referohen në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Prokuroria e Përgjithshme ka vazhduar të ushtrojë funksionet në këtë drejtim. Gjatë këtij viti janë administruar 185 raste për verifikimin e thelluar, 137 nga këto kanë të përcjella nga Departamenti i Administratës Publike, 5 i ka sjelle KQZ-ja dhe 43 subjekte vetëdeklaruese janë sjellë me kërkesë për verifikim nga Kuvendi. Për 147 raste ka përfunduar procesi.

Kategoritë e zyrtarëve të verifikuar kanë qenë: 27 nëpunës të nivelit ekzekutiv, 45 nëpunës të nivelit të mesëm drejtues, 30 nëpunës të nivelit drejtues dhe 45 zyrtarë të lartë. Për 44 zyrtarë të lartë është konstatuar se nuk përfshihen në sferën e ndalimeve, ndërsa për 1 prej tyre ka rezultuar se përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit.

Si konkluzion, referuar numrit të çështjeve, llojeve, shtrirjes territoriale të tyre, intensitetit, formave të kriminalitetit dhe masave të tjera të analizuara më sipër dhe në mënyrë më të hollësishme në raport, organi i prokurorisë duket se i ka përmbushur detyrat kushtetuese, ligjore dhe ka zbatuar rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit European dhe prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit.

Prioritetet tona për vitin 2019, janë si më poshtë:

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, nëpërmjet rritjes së hetimeve proaktive, hetimeve pasurore, forcimit të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese vendase, ashpërsimit të politikës penale, trajnimeve të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore. Gjithashtu, prioritet përbën garantimi i pavarësisë së prokurorëve, integritetit dhe profesionalizmit të tyre në ushtrimin e funksioneve kushtetuese. Rritja dhe forcimi i bashkërendimit ndërinstitucional i të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë penale, për të rritur efikasitetin e sistemit të drejtësisë penale. Ngritja e strukturave të posaçme pranë prokurorive të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, forcimi i kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore për ushtrimin efikas të ndjekjes penale dhe hetimit pasuror për çështjet që do jenë kompetencë lëndore e prokurorive të rretheve pas krijimi të SPAK-ut. Forcimi i kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve të prokurorëve, oficerëve të Policisë Gjyqësore dhe nëpunësve civilë në prokurori. Nxjerrja e rregulloreve dhe udhëzimeve të përgjithshme me natyrë administrative dhe procedurale në bashkëpunim me EURALIUS me synim qartësimin

e kuptimit dhe të zbatimit në praktikë të kuadrit ligjor përkatës dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

ne mendojmë të miratojmë udhëzime që unifikojnë të drejtat dhe detyrimet e prokurorit në ushtrimin e funksioneve, marrëdhëniet e tij me drejtuesin e prokurorisë, si prokuror më i lartë, informimin dhe koordinimin në veprimtarinë e prokurorisë, pasi kemi konstatuar problematika gjatë punës së këtij viti.

Gjithashtu, një udhëzim që mendojmë të miratojmë, është udhëzimi për të unifikuar mënyrën e shpërndarjes së informacionit për publikun, lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, si dhe për të garantuar ruajtjen e sekretit të hetimeve.

Gjithashtu, do të miratohet një udhëzim për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit, si dhe për të unifikuar e orientuar prokurorët në kërkesat për caktim masash sigurimi në drejtim të ashpërsimit të politikës penale për disa grupvepra dhe krime të rënda.

Një prioritet tjetër është garantimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut në të gjitha fazat e ndjekjes penale. Ky është prioritet vit pas viti, dhe natyrisht që duhet të jetë gjithmonë nën monitorim. Gjithashtu, është edhe përdorimi me efektivitet i fondeve buxhetore për përmirësimin e infrastrukturës në prokurori. Kaq!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Marku!

Në fakt, janë 308 faqe raport, dhe së bashku me shtojcën që e shoqëron raportin është voluminoz dhe i detajuar. Përpara se t'ia kaloj fjalën koleges sime, relatores, zonjës Hysi, për të cilën jam i bindur se ka bërë një përmbledhje të gjetjeve të raportit të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018, për të qenë korrekt dhe për të mos pasur asnjë lloj aludimi, raportimi i zonjës Marku sot në Komisionin e Ligjeve e në Komisionin e Sigurisë, në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë për vitin 2018, bëhet si Prokurore e Përgjithshme në detyrë. Pra, që të jem korrekt.

Fjalën ia kaloj zonjës Hysi. Më pas do të ketë pyetje nga kolegët.

Fjala është për ju, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë!

Më lejoni të falënderoj prokuroren e Përgjithshme në detyrë, si dhe stafin që ka punuar për hartimin e këtij raporti, i cili është në dispozicionin tonë dhe është depozituar në përputhje me rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, me manualin e përgatitur nga Kuvendi i

Shqipërisë, e njëkohësisht në përputhje edhe me detyrimet që burojnë nga Kushtetuta dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Sikurse e tha edhe kryetari i Komisionit të Ligjeve, raporti është voluminoz. Janë 308 faqe, plus shtojca, e cila përmban të dhëna të detajuara për veprimtarinë e prokurorisë, në lidhje me parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.

Ky raportim, të nderuar kolegë, nuk është raportim për aspektet administrative të punës së Prokurores së Përgjithshme në detyrë, por është raportim për gjendjen e kriminalitetit.

Kjo është kërkesa që ka Kushtetuta dhe ligji në raportet midis Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë apo Prokurorit të Përgjithshëm që presim ta zgjedhim shumë shpejt, dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Nuk do të hyj në detaje për statistikën, pasi nëse do të merreshim me statistikën, interpretimi i tyre mund të ishte nga më të ndryshmit, por do të doja të theksoja se në shtator të vitit 2018, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar një rezolutë, me të cilën i ka kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë, që të përmbushë disa rekomandime, me qëllim që të rrisë efektivitetin në luftën kundër kriminalitetit në tërësi, dhe sidomos formave të tij të veçanta.

Gjithsej janë 13 rekomandime. Megjithatë koha ishte e shkurtër, pasi janë miratuar më 20 shtator të 2018-ës, nga analiza e kryer nga Shërbimet e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura, pranë Kuvendit të Shqipërisë, raportimi që ka bërë prokuroria në mekanizmin ndër-institucional për ndjekjen sistematike të zbatimit të rekomandimeve, si dhe nga analiza që kam bërë unë pasi kam lexuar këtë raport, rezulton se të 13 rekomandimet janë përmbushur, prej të cilave 12 në mënyrë të plotë, ndërsa një rekomandim është përmbushur në mënyrë të pjesshme. Konkretisht, rekomandimi i përmbushur në mënyrë të pjesshme, që u evidentua edhe nga Prokurorja e Përgjithshme në detyrë, ka të bëjë me rritjen e numrit të hetimeve pasurore, për identifikimin, sekuestrimin, konfiskimin e pasurive, mjeteve, produkte të veprës penale, me origjinë kriminale e organizuar, sipas ligjit antimafia, thënë shkurt, por që është ligji “Për goditjen e krimit të organizuar dhe veprave të korrupsionit nëpërmjet pasurisë”

Konkretisht, edhe si transparencë për ju, publikun dhe medien, katër rekomandimet e para, të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë kanë lidhje me rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit të funksionarëve të sistemit të drejtësisë, si dhe të funksionarëve të tjerë të lartë, por edhe për rritjen e goditjes e të hetimeve proaktive ndaj trafikut të narkotikëve e kultivimit.

Ka të dhëna që janë të sqaruara qartë e saktë në raport, por njëkohësisht, edhe Shërbimet e Monitorimit të Pavarur kanë bërë një analizë, të nderuar kolegë. Njëkohësisht, ky

aspekt ose këto rekomandime janë analizuar edhe nga ministrja e Drejtësisë, e cila ka raportuar disa ditë më parë në Komisionin e Ligjeve.

Në lidhje me aspektin e dytë të rekomandimeve, janë ato që lidhen me reformën në drejtësi. Konkretisht, janë tre rekomandime që ne i kemi lënë prokurorisë dhe Prokurores së Përgjithshme në detyrë. E para është ndihma që duhet të japë organi i prokurorisë në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve, pra duke bërë vlerësimin e kandidatëve për organet e vetingut, siç njihen nga publiku. Dy rekomandimet e tjera të rëndësishme janë përdorimi i institucioneve të reja, që ne kemi parashikuar në kuadrin e reformës në drejtësinë penale, konkretisht në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Drejtësisë Penale të të Miturve, si dhe kontributi gjithëpërfshirës në drejtim të aspekteve të tjera të reformës në drejtësi, me të cilën lidhet puna e prokurorisë dhe e institucioneve të tjera. Të tre rekomandimet janë të zbatuara, me gjithë vështirësinë që ka njohja e institucioneve të reja.

Mua më vjen mirë, zonja Prokurore e Përgjithshme në detyrë, që ju keni evidentuar disa nevoja e rekomandime të punës suaj për vitin 2019, dhe do të vlerësoja në mënyrë të veçantë sugjerimin që ju bëni lidhur me informimin më të mirë të publikut, të qytetarëve, të palëve, për të njohur institucionet e reja që parashikon reforma në drejtësi, do të thosha një formë e edukimit ligjor dhe lehtësimit të informacionit, duke përdorur një gjuhë sa më të thjeshtë për publikun.

E them këtë, të nderuar kolegë dhe kolege, sepse reforma në drejtësi nuk është vetëm vetingu. Të gjithë e kanë kuptuar sikur reforma në drejtësi është vetëm rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve e prokurorëve në tre komponentët e tyre: pasuri, etikë e profesionalizëm. Reforma ka edhe shumë aspekte të tjera, që për fatin tonë të keq, do të thosha, nuk u është dhënë vëmendja e duhur për shkak edhe të debateve shumë të mëdha dhe përqendrimit të vëmendjes tek organet e vetingut, ndërkohë që qytetarët kanë mundësi të përdorin një sërë institutesh të tjera.

Kam lexuar me vëmendje atë pjesë të raportit ku analizoni institucionet e reja, të përfshira në Kodin e Procedurës Penale, por edhe vështirësitë. Pajtohem dhe ndaj të njëjtin mendim me ju e me ata që kanë hartuar raportin, me stafin tuaj, se nuk është e lehtë të flasësh për gjykime të drejtpërdrejta apo të përdorësh marrëveshjet, në një kohë kur mentaliteti dhe kultura juridike nuk na ka rezultuar ajo që duhet. Është kjo arsyeja pse kemi miratuar një strategji të edukimit ligjor, ku si një komponent të rëndësishëm të strategjisë kemi vënë edukimin ligjor lidhur me reformën në drejtësinë penale në përgjithësi, dhe në drejtësinë e të miturve në veçanti, me fokus edhe te viktimat, si dhe lehtësimin e prokurorisë nga çështjet e rrezikshmërisë së vogël, ato që ne i quajmë krime të vogla, për të cilat nuk ka nevojë të

investohet aq shumë, kur ka alternativa të tjera, si ndërmjetësimi, shmangia, apo puna më e mirë që duhet bërë për parandalimin nga të gjitha institucionet e tjera penale ose jopenale.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2018, i kemi kërkuar Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë dy rekomandime: forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë e huaja ligjzbatuese dhe me partnerët rajonalë e ndërkombëtarë.

Të dyja rekomandimet rezultojnë të përmbushura. Të njëjtin konstatim ka edhe ministrja e Drejtësisë, në vlerësimin që i ka bërë këtij lloj bashkëpunimi.

Padyshim, ka një sërë problemesh, që ju vetë i keni përmendur në raport, dhe besoj se ne do të jemi të kujdesshëm në hartimin e rezolutës, për ta adresuar të gjitha shqetësimet që ngre organi i prokurorisë, por që ka nevojë edhe publiku të ketë një parandalim dhe goditje më efektive të luftës kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera. Nuk duhet të harrojmë se përgjegjësia jonë në Kuvend është e shumëfishtë, sepse nuk jemi vetëm dy komisione që mund të kontribuojmë në parandalimin ose në krijimin e të gjitha kushteve që prokuroria të parandalojë dhe të dënojë kriminalitetin, por ka edhe komisione të tjera në parlament, pasi një pjesë e mirë e veprave penale kërkojnë adresime me masa jopenale. Për shembull, lidhur me treguesit e kriminalitetit që paraqiten qartë në raport, se vendin kryesor e zënë veprat penale kundër pasurisë, me 33,67%, besoj se të gjithë jemi dakord se ka nevojë për një angazhim më të mirë të të gjitha instrumenteve për parandalimin e tij; veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës apo veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, shkatërrimi i pronës dhe falsifikimi i dokumenteve janë vepra penale, që, krahas politikës penale, kanë nevojë edhe për politika sociale. Besoj se edhe komisionet e tjera dhe mekanizmi ndërinstitucional do të angazhohet t'i adresojë më mirë dhe të ketë një ulje të kriminalitetit në këto fusha.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, në rezolutën e vitit 2018 ka pasur edhe dy rekomandime lidhur me politikën penale. Njëri rekomandim adresonte ashpërsimin e politikës penale për masat e sigurisë kur bëhet fjalë për krimin e organizuar, korrupsionin, krime kundër jetës, pastrim parash dhe krimi ekonomiko-financiar. Rekomandimi i dytë i Kuvendit ka qenë për një politikë penale sociale më humane ndaj disa kategorive, të cilat, për fatin e mirë ose të keq të tyre, kryejnë vepra penale, siç janë të miturit, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara. Nga analiza e bërë në raport edhe nga Shërbimi i Monitorimit, por edhe nga studimi i detajuar që i kam bërë raportit rezulton se orientimet e politikës penale, sipas rekomandimeve tona, janë zbatuar, por kanë nevojë për një politikë penale më të ashpër lidhur me veprat penale të korrupsionit, të krimit të organizuar, ku pa dyshim këtu ka vend edhe për angazhimin e organeve të gjyqësorit. Ne sot kemi mundësi që në një mbledhje të dytë të Komisionit të Ligjeve, ku do të raportohet nga Komisioni i Pavarur për Monitorimin e Zbatimit të ligjit për

ngritjen e organeve të reformës në drejtësi të marrim një informacion për përmbushjen e detyrimeve që kanë KLGJ-ja dhe KLP-ja, të cilat kanë përgjegjësi për mbarrëvajtjen e punës së organeve të drejtësisë dhe të prokurorisë në momentin kur ne Prokurorin e Përgjithshëm e kemi zhveshur nga një sërë kompetencash, që lidhen me ndjekjen penale dhe me zbatimin në praktikë të ndjekjes penale në çështjet konkrete.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, një nga problemet që ngrihet në raport nga Shërbimi i Monitorimit, por që dua ta ndaj edhe unë, është nevoja e thellimit të bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ILDKPI-së. Institucionet kanë raportuar në Kuvendin e Shqipërisë, respektivisht në komisionet tona. Besoj se ka nevojë të theksohet rritja e bashkëpunimit midis këtyre institucioneve, por bashkohem edhe sugjerimin e zonjës Marku, e cila theksoi nevojën për rritjen e trajnimit dhe profesionalizmit të institucioneve, rritjen e cilësisë së raportimeve apo denoncimeve që bëjnë, si dhe për bashkëpunim më efektiv të tyre, me qëllim që referimet të jenë cilësore, të mbështetura në prova, por edhe cilësia e hartimit dhe gjykimi të jenë të drejta.

Nuk duhet të harrojmë që ne kemi miratuar ligjin për Policinë Gjyqësore, ku besoj se disa nga shqetësimet që ju keni ngritur në raport, por edhe atë që ju thatë në fjalën tuaj për nevojën e trajnimit të Policisë Gjyqësore do të jenë disa nga rekomandimet tona, pasi ne e vlerësojmë rolin e Policisë Gjyqësore, të shërbimeve pranë policisë dhe pranë seksioneve të prokurorisë.

Të nderuar kolegë, ka një rekomandim të bërë nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me prokuroren e Përgjithshme në detyrë për të ndjekur në vazhdimësi rastet e zbatimit të ligjit për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike, me qëllim garantimin e sigurisë së pastërtisë së figurave. Ky është një angazhim që i kemi ngarkuar Prokurorisë së Përgjithshme, ku Kuvendi e ka vlerësuar. Edhe kur ka ardhur sekretari i Përgjithshëm ne i kemi dhënë mundësinë për buxhet dhe për një shtesë modeste të burimeve njerëzore, ku besoj se kjo detyrë është përmbushur dhe ky rekomandim është i plotësuar. Këto ishin ato sa u përket detyrimeve që Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet rezolutës i ka lënë Prokurores së Përgjithshme në detyrë.

Në fund të fjalës sime dua të evidentoj edhe disa rekomandime ose nevoja që ne si Kuvend mund t'i përmbushim. Ne jemi jo vetëm organ që hartojmë ligje dhe i miratojmë ato, por kemi edhe një rol shumë të rëndësishëm në ushtrimin e kontrollit parlamentar dhe nxitjen e të gjitha institucioneve për të bashkërenduar punën e tyre për të pasur një efektivitet më të mirë të parandalimit dhe goditjes së kriminalitetit në tërësi dhe formave të veçanta të tij në veçanti. Në këtë kuadër, besoj se të gjitha të dhënat statistikore për kriminalitetin duhen lexuar

me kujdes nga ana jonë sa herë që ne miratojmë ligje ose ushtrijmë kontroll parlamentar në fusha të caktuara. Shumë nga ligjet që ne kemi miratuar, jo penale, por të tjera, që adresojnë çështje sociale, besoj se po t'i monitorojmë mirë dhe qeveria t'i zbatojë drejt do të adresojmë një sërë shqetësimesh që lidhen me forma të veçanta të kriminalitetit, për të cilat nuk ka nevojë të kemi vepra penale të tilla dhe angazhim të prokurorisë kur mund të përdoren më mirë alternativat jashtëgjyqësore.

Zonja Prokurore e Përgjithshme në detyrë, ju ndoqa me vëmendje lidhur me shqetësimin që ju ngrini për ndikimin që kanë organet e procesit të vetingut te prokuroria. Pa dyshim, të gjithë ne e kemi të qartë që ju nuk keni më përgjegjësi dhe kompetenca drejtpërdrejt në ecurinë e çështjeve, por unë vlerësoj të gjitha udhëzimet që ju keni nxjerrë në një periudhë shumë të shkurtër, tetor-nëntor, pas miratimit të rezolutës së Kuvendit, por besoj se ka vend për të nxjerrë edhe udhëzime të tjera për t'i unifikuar praktikën në nivelin e prokurorisë për kategori të caktuara veprash penale, ku unë pajtohem me ato rekomandime që ju keni bërë. I vetmi shqetësim imi është se si mundet që brenda një periudhe të shkurtër, nga momenti që do të miratohet rezoluta, e cila besoj se do të jetë brenda muajit qershor deri në muajin dhjetor, të mund të përmbushen të gjitha rekomandimet që ju i bëni vetes suaj, të cilat na rezultojnë të domosdoshme, por që koha në dispozicion nuk më duket realiste dhe e mjaftueshme, për aq kohë sa ne do të procedojmë me zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm dhe atë detyrë do t'ia kërkojmë atij që do të zgjidhet në Kuvendin e Shqipërisë.

Së dyti, ju ndoqa me vëmendje lidhur me problemin e statistikave dhe pajtohem absolutisht se problemi i statistikave gjyqësore në Shqipëri, sidomos penale, përbën një problem. Pa dyshim që unë e njoh progresin e bërë, por do të doja të dija nga ju dhe të dëgjoja se çfarë do të kërkonin nga Kuvendi i Shqipërisë, nga dy komisionet respektive, për të pasur njëherë e përgjithmonë një sistem të unifikuar të statistikave. Kjo është një kërkesë që ka bërë Qendra Ndërkombëtare e Parandalimit të Krimit në Vjenë, që i ka kërkuar Shqipërisë prej më shumë se 10 vjetësh të ketë një sistem statistikash që gjurmon çështjet, por edhe që monitoron zbatimin e të gjitha rekomandimeve të CEPEJ-it apo të standardeve të tjera.

Gjithashtu, vlerësova shqetësimin tuaj lidhur me moszbatimin e mbikëqyrjes elektronike, i cili është një shqetësim që ne e kemi diskutuar edhe kur kemi bërë diskutimet e projektligjeve të paketës së reformës së drejtësisë penale, edhe kur kemi diskutuar ligjin për ekzekutimet e vendimeve penale dhe ndryshimet që kemi kaluar në vitin e kaluar. Ne mirëpresim Ministrinë e Drejtësisë për të përcjellë sa më shpejt paketën e ndryshimeve të nevojshme, por edhe zbatimin e këtij ligji, i cili do të ulë kostot dhe ngarkesën në organet e prokurorisë.

Dua të dëgjoj nga ju se çfarë do të kërkonit konkretisht nga Kuvendi i Shqipërisë lidhur me rritjen e efektivitetit të bashkëpunimit ndërinstitucional për konfiskimin e pasurive nga veprimtaritë kriminale.

Të nderuar kolegë, ky ishte prezantimi im. Ka shumë çështje që mund të diskutohen. Ky është raporti më i rëndësishëm që ka shqyrtuar Kuvendi për këtë vit dhe që ka një sensibilitet, jo midis nesh, sepse mund të përdoret politikisht, por për publikun, sepse parandalimi i krimit dhe lufta kundër tij janë të rëndësishme. Këto janë të rëndësishme edhe në kuadër të hapjes së negociatave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka kërkuar kolegja e Komisionit të Sigurisë, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Mirëdita, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme!

Faleminderit, zonja Hysi, për relatimin!

Dua të them se, në fakt, ne kemi proceduar me një relator të vetëm, edhe pse duhet të jemi dy komisione në këtë dëgjese, për arsyen e thjeshtë se në traditën e parlamentit, por, edhe për shkak të përshkrimit të punës që ka Komisioni i Ligjeve, Prokuroria e Përgjithshme, si një institucion kushtetues i pavarur, vazhdimisht ka raportuar në këtë komision. Ndërkohë, për çështje të tjera, ka pasur të bëjë edhe me komisionin tonë, me Komisionin Parlamentar të Sigurisë.

Megjithatë, nuk e mora fjalën për të vënë në pah raportin e Komisionit të Sigurisë me Prokurorinë e Përgjithshme, por për të shprehur edhe një herë se ne jemi këtu për shkak të një detyrimi të ndërsjellë. Pra, Kuvendi i Shqipërisë ka detyrimin që të paktën 1 herë në vit ta pyesë Prokurorin e Përgjithshëm, ta pyesë institucionin për gjendjen e kriminalitetit në vend, të njohë të dhënat e kriminalitetit dhe, natyrisht, duke njohur të dhënat, të mbërrijë deri te shkaqet e kriminalitetit. Duke njohur shkaqet, Kuvendi i Shqipërisë, sigurisht, ka të gjitha mundësitë dhe atributet ligjore për të përmirësuar instrumentin legjislativ, me qëllim që nevojat e punës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të luftës kundër kriminalitetit në përgjithësi të mund të akomodohen sa më mirë të jetë e mundur.

Nga ana tjetër, është detyrim i Prokurorisë së Përgjithshme, sikundër i çdo institucioni tjetër të pavarur, kushtetues ose jo, që të vijë në Kuvendin e Shqipërisë të raportojë për detyrën e saj. Nga kjo pikëpamje, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve, por edhe të medias, që roli i Kuvendit është përmirësuar ndjeshëm në këtë drejtim, sepse për disa nga ne këtu, që jemi deputetë pak me më shumë përvojë se të tjerët, ka ndodhur që për vite me radhë, për shkak të

humorit, të marrëdhënies së këtij institucioni dhe ekzekutivit me institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurori i Përgjithshëm nuk është thirrur fare në parlament. Kështu që mund të themi se kemi shënuar një akt përpara.

Natyrisht, ky trend duhet mbajtur pa asnjë diskutim, sepse është detyrim kushtetues, sikundër edhe qasja jonë, në raport me njohjen e kriminalitetit, duhet të ndryshojë, sepse tanimë reforma në drejtësi ka konfiguruar institucione të reja dhe do të na duhet që, për të pasur një panoramë të qartë të gjendjes së kriminalitetit në vend, të mos kemi këtu vetëm institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, por të kemi edhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, apo SPAK-un, që do të jetë nesër, për ta kuptuar më mirë dhe për ta adresuar më mirë punën tonë.

Nuk dua të zgjatemi në këtë pikë. Sigurisht, ne nuk jemi mbledhur këtu për të shuar kuriozitete për çështje të veçanta, por jemi mbledhur për të bërë punën tonë dhe për ta orientuar punën tonë, sipas atyre nevojave që shprehu Prokurorja e Përgjithshme në detyrë, por edhe zonja Hysi në relatinin e saj në emër të Komisionit të Ligjeve.

Kështu që dua të ftoj kolegët deputetë, sipas Rregullores, të bëjnë pyetje, por ju kujtoj se Rregullorja dhe ligji organik i Prokurorisë së Përgjithshme i ndalojnë pyetjet për çështje konkrete. Ju kujtoj edhe një herë se raportimi është për vitin 2018. Kështu që të kemi mirëkuptimin që t'i qëndrojmë korrektë natyrës së pyetjeve që duam t'u drejtojmë Prokurores së Përgjithshme në detyrë dhe stafit që e shoqëron sot.

Kështu që fjala është për kolegët e të dyja komisioneve.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Maliqi, meqenëse e ndezët i pari mikrofonin.

Zoti Maliqi, do të procedojmë me formën që jo të merren pyetjet nga të gjithë kolegët, pastaj të jepen përgjigjet në bllok, por do të jepen përgjigje për secilën pyetje dhe për secilin koleg, por duke respektuar atë që tha kolegja Felaj, pra bëhet fjalë për raportimin e vitit 2018, dhe duke ruajtur kufizimet që na detyron ligji.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht, kam një falënderim për punën dhe raportimin që bëri Prokurorja e Përgjithshme, e cila nuk ka të bëjë me fletët “308”, “500” apo “1 mijë”, por ka të bëjë me rezultatet e drejtpërdrejta në luftën ndaj krimit. Këtu u bë raportim i vitit 2018, faktikisht publiku, mediet e me radhë presin nga Prokuroria e Përgjithshme goditje dhe arrestime të bujshme të peshqve të mëdhenj, siç ka thënë ish-ambasadori amerikan, dhe të jeni të bindur se, pavarësisht këtyre goditjeve për vjedhje falsifikime, drogë me 30 gramë, bosët e drogës janë jashtë, bosët e krimit janë në qeveri, janë ish-qeveritarë dhe ministra, janë në parlamentin e Shqipërisë, janë drejtues institucionesh, drejtues të vendit dhe të lidhur me bosët e tjerë jashtë,

që e kanë çuar vendin në këtë gjendje. Ky është një realitet i dhimbshëm, prandaj edhe puna e institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme është në përputhje me situatën e funksionimit të shtetit.

Më bëhet qejfi që sot janë dy komisione këtu, Komisioni i Sigurisë dhe Komisioni i Ligjeve. Organi i prokurorisë e ka të mbështetur punën edhe te rezultatet e Policisë së Shtetit, që nga parandalimi, goditja dhe veprimet e para hetimore, më pas bëhet hetimi nga prokurori derisa shkohet për gjykim. Por dua të këmbëngul që njerëzit pa përkrahje ekonomike vuajnë në burgjet e Shqipërisë dënime për vepra penale të ulëta me shumë vjet, ndërkohë ata për vepra të rënda janë dënua me më pak vjet, për shkak të ndërhyrjeve që ka pasur në sistemin e drejtësisë dhe në politikën shqiptare.

Jo më larg nga këtu, para disa vjetësh ndodhi vrasja e bujshme e Artan Santos, pranë qeverisë, pranë parlamentit të Shqipërisë, pra në qendër të Tiranës. Dua të di: a ka një grup të përbashkët, apo ju thjesht keni bërë një dosje pezullimi hetimor dhe ia keni lënë policisë për të mbushur numrin e dosjeve? Sa janë këto dosje hetimore të pezulluara për vitin 2018, të cilat ia keni deleguar Policisë së Shtetit? Më rezulton se janë me qindra e mijëra dosje jo vetëm për vitin 2018, por edhe të viteve më parë, që kanë zënë myk në kartotekë apo në Policinë e Shtetit.

Çfarë është bërë për dosjet e përgjimit, të cilat kanë dalë nga mediet për vjedhje votash? Pra, pse është kjo vonesë, sepse janë bërë publike edhe nga “Zëri i Amerikës”, nga mediet e të tjera e me radhë?

Dua të di nga Prokuroria e Përgjithshme nëse është e plotësuar organika dhe a ka nevojë për më shumë burime njerëzore për t’i mbuluar këto vepra penale?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Maliqi!

Në mos gabo, janë 3 pyetje: një që ka të bëjë me pezullimin e dosjeve për moszbulim autori, një me sensibilitetin e disa dosjeve aktuale dhe një në lidhje me burimet njerëzore.

Urdhëroni, zoti Braho, për procedurë!

Spartak Braho – Ky raportim ka një specifikë të veçantë: është raportimi i Prokurores së Përgjithshme për çështjet e kriminalitetit. Prandaj nuk është e udhës, madje është e ndaluar që Prokuroria e Përgjithshme të flasë për çështje konkrete. T’i shmangim pyetjet për çështje konkrete.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Atë e theksoi edhe kolegja ime Felaj. Natyrisht që është në diskrecionin e Prokurores për të dhënë përgjigje ose jo për pyetjet, që konsiderohen shkelje të sekretit hetimor. Para se t’ia kaloi fjalën zonjës Marku, dua të them se ky është raportim për gjendjen e kriminalitetit

për vitin 2018, por është detyrim edhe i këtij komisioni respektimi i atyre kufizimeve që na vendos ligji, konkretisht Kodi i Procedurës Penale, në raport me sekretin hetimor.

Zonja Marku, po jua kaloj fjalën në lidhje me pyetjet e kolegut Maliqi.

Arta Marku – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Maliqi, ju falënderoj për pyetjet e bëra!

Do të doja të filloja nga një deklaram juaji për bosët e krimit, që gjenden në qeveri e ku di unë se ku. Dua të them që Prokuroria e Përgjithshme nuk e ka më atribut hetimin ose ndjekjen penale. Nëse ju keni ndonjë të dhënë ose prova, mund t'i drejtoheni Prokurorisë për Krimet e Rënda, madje ju ftoj ta bëni këtë.

Për sa u përket dosjeve të pezulluara, numrin e dosjeve e keni në raport, është një shifër që, krahasuar me një vit më parë, ka ardhur në ulje. Nëse kërkon detaje lidhur me numrin e çështjeve, janë të gjitha në raport.

Për sa i përket dosjes, për të cilën folët, për vrasjen e bankierit Artan Santo, së pari, është jashtë periudhës për të cilën po raportojmë sot.

Së dyti, është një çështje konkrete dhe nuk mund t'ju jap asnjë lloj të dhëne në lidhje me të, por parësore është se i përket një periudhe jashtë raportimit të sotëm.

Çfarë është bërë me dosjet, ku kanë dalë përgjimet? Është fakt i njohur, tashmë publik, që vazhdojnë të jenë në hetim. Nëse do të kishte ndonjë vendimmarrje, do të ishte marrë vesh. Unë e kam shprehur disa herë edhe gjatë analizave në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, qoftë edhe në daljet e mia publike, që aty ka një problematikë: dosjet janë zvarritur, janë mbajtur pa veprime, ka pasur vetëm përgjime të shumë numrave telefonikë, të cilët, veçse janë bërë, por nuk janë zbardhur. Nëse nuk zbardhen, nuk transkriptohen, ato janë të palexueshme. Aktualisht, këtyre çështjeve u është dhënë e gjithë rëndësia e duhur.

Për sa i përket dosjes “339”, po hetohet nga një grup prej dy prokurorësh dhe 11 oficerësh të Policisë Gjyqësore. Ka pasur 700 CD dhe video të patranskriptuara, por po punohet për këtë. Ju garantoj se shumë shpejt do të ketë një vendimmarrje të prokurorëve dhe do të bëhet publike.

Gjithashtu, edhe dosja “184” ka qenë në të njëjtën gjendje: ka qenë e regjistruar, por vetëm për dy vjet ka pasur vetëm përgjime, por pa asnjë lloj veprimi hetimor. Pas dy vjetëve janë regjistruar emrat e disa personave nën hetim dhe situata është kjo: ka një prokuror tjetër që po i heton dhe po bëhet transkriptimi i tyre. Besoj edhe për këtë çështje do të ketë një vendimmarrje të shpejtë. Unë këtë gjë u kam kërkuar prokurorëve që të hetojnë shpejt, pa cenuar cilësinë, dhe të dalin me vendime për çështje që kanë tronditur politikën shqiptare.

Për sa u përket burimeve njerëzore, nuk e kuptova pyetjen, e kishit fjalën për organikën në Prokurorinë e Përgjithshme, apo në tërësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, siç e dimë, po ndodhin shkarkime të shumta prokurorësh. Ndaj, po t'ju them se burimet njerëzore janë të plota, ju gënjej. Situata përkeqësohet dita-ditës në drejtim të ngarkesës dhe të nevojës për prokurorë, por kësaj nuk kemi çfarë t'i bëjmë. Prokurorët vijnë vetëm nga Shkolla e Magjistraturës dhe ne do të duhet të presim të paktën tre vjet që të kemi hyrje të reja në sistem. Por unë mendoj se ngarkesa e punëve mund të përballohet me oficerë të Policisë Gjyqësore dhe me shtim të stafit administrativ, në sajë të trajnimeve të tyre, në ndihmë të punës së prokurorëve.

Nuk e di nëse isha e qartë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Marku!

Fjalën e ka kërkuar zoti Murrizi, për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Zoti kryetar, e kam me ju. Meqenëse zonja prokurore u shpreh se nuk raporton dhe nuk jep përgjigje për pyetjet që i përkasin Prokurorisë së Krimeve të Rënda, shtroj pyetjen: Prokuroria e Krimeve të Rënda raporton në Kuvend?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka me ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Që të jemi të qartë, ligji ia ngarkon Prokurorit të Përgjithshëm edhe raportimin në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, por edhe raporti dhe të dhënat (treguesit) e punës së Prokurorisë së Krimeve të Rënda janë pjesë integrale e raportit prej 308 faqesh dhe shtojcës, që është pjesë e raportimit të sotëm të Prokurores së Përgjithshme. Pra, nuk do të ketë raportim të drejtuesve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda në Kuvend.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërkohë, me ngritjen e organeve të reja të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe këtu e kam fjalën për SPAK-un, natyrisht që do të kemi raportim veçmas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sot jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse e morët fjalën për procedurë, mund të vazhdoni edhe me pyetjet.

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Po e nis nga përgjigjja e fundit e zonjës Marku lidhur me 700 CD-të e përgjimeve. Ajo thotë: “Janë përgjuar prej vitesh, por nuk janë transkriptuar”. Janë përgjuat kot, për qejf, këta? Është kthyer si *call center* Prokuroria e Përgjithshme me ju ose me paraardhësin tuaj? Përgjohen për të bërë videoklipe dhe rrinë aty, në kuptimin që, çfarë të dalë ndonjë gjë që na intereson, ta zbardhim; po nuk doli ai që kemi qejf ne, e lëmë CD-në të flejë?! Pra, qenkan 700 CD dhe nuk e paska marrë kush mundimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di se për sa vite është arritur në shifrën 700, por ia paskeni kaluar Kinostudios me filmat që ka bërë nga '48-a deri te “Vdekja e kalit”?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Desha të di: çfarë është kjo lloj gallate me taksat e qytetarëve shqiptarë, që harxhohen para për ata që mbajnë kufjet në vesh, për ato 700 CD? Po t'i kishte Sinan Hoxha, do të kishte bërë goxha lekë me to.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ka mundësi që nuk merrni kurrfarë angazhimi, as më minimalin për të bërë transkriptimin e tyre, flas si institucion, se ndoshta nuk ka qenë pjesa juaj individuale, por lihen të flenë? Ç'është kjo lloj metode pune: hajde të bëjmë përgjime, po na doli ndonjëri, që duam ta godasim, mirë, por, po na doli ndonjëri që e kemi xhan, themi që nuk transkriptohet CD-ja?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të themi edhe nëse dëgjohet ose jo.

Pyetja e dytë. Nga numri voluminoz i procedimeve për vitin 2018, që janë 32 mijë, me sa u përpoqa të mbaj shënime gjatë fjalës suaj, shoh se 10 mijë ishin të mbartura nga viti 2017. Nga 42 mijë procedime në total, vetëm 109 procedime janë të regjistruara kryesisht. A nuk shihni se ka një lloj parazitizmi të një trupe prej rreth 400 prokurorësh dhe 170 OPGJ-ve, që janë brenda prokurorisë? Jeni kthyer, në njëfarë mënyre, si dogana, që prisni kush t'ju vijë tek trau!

Vetëm 109 procedime kryesisht?! Unë nuk e di, por ju prisni vetëm kush të vijë të denoncojë? Ju nuk filloni fare, nuk keni as dëllin për të filluar çështje kryesisht, me të gjitha indiciet publike, si denoncimet nga ana e medias, të politikës, të qytetarëve?

Pyetja e tretë. Nga numri i përgjithshëm i trupës së prokurorëve që ka Shqipëria, sa u janë nënshtruar procesit të vetingut, sa nga këta janë larguar nga vetingu dhe a ndiheni ju përgjegjëse për një anëtar të KLP-së, i cili ka ardhur nga ju, me firmën tuaj, që ka rezultuar bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, me pseudonimin “Venusi”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka ardhur nga prokuroria juaj.

A keni ju njëfarë përgjegjësie morale, se ligjore nuk e di ekzaktësisht se sa, që brenda 11 anëtarëve të KLP-së ka njerëz të larguar nga prokuroria, me motivacion “jo të fisëm dhe të moralshëm” për të qenë sot pjesë e trupës që do të emërojnë, do të gradojnë dhe do të lëvizin 400 prokurorët e Shqipërisë në KLP, siç është, për shembull, Nurihan Seitaj? Zonja në fjalë ka qenë gjyqtare dhe ka dënuar, pas vdekjes së Enver Hoxhës, njerëz që kanë sharë Enver Hoxhën. Këta do ta bëjnë drejtësinë e 400 prokurorëve tuaj?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Cili është bashkëpunimi juaj me Ministrinë e Brendshme, përderisa vitin e kaluar në një show televiziv u mbledhët në zyrën e zotit Xhafaj, mos gaboj, dhe firmosët një memorandum bashkëpunimi ndërmjet jush, drejtorit të SHIK-ut, ministres së Drejtësisë dhe ish-ministrit Xhafaj? Neve, si Komision Sigurie, dhe këtu janë të gjithë kolegët, nga inspektimet që kemi bërë në drejtoritë përkatëse të policive na rezultojnë shifra të kundërta me shifrat që ju relatuat këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fjalën tuaj thatë se kriminalitet më të lartë kanë pasur qarku i Durrësit dhe ai i Fierit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në drejtorinë e policisë së Fierit na u tha: “Kriminaliteti te ne është më i ulët sesa ai i Elbasanit dhe i Lezhës”. Pra, a keni ju njëfarë bashkëpunimi, meqenëse keni firmosur edhe atë raportin e famshëm me katër ministrat?

Arta Marku – Zoti Murrizi, ju lutem, a mund t’u përgjigjem disa prej pyetjeve deri tani, pastaj pyetjeve të tjera që mund të keni? Nuk po arrij t’i mbaj shënim të gjitha.

Myslim Murrizi – Meqenëse shoh gjashtë veta, mendova që secili të shkruajë nga një pyetje, apo e kanë bezdi?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Marku, stafi që ju shoqëron...

Myslim Murrizi – Mund të shkruajnë këta të tjerët, apo kanë ardhur për të përgjuar, për të bërë CD?

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Murrizi!

Zonja Marku, stafi që keni me vete...

Myslim Murrizi – Të shkruajnë këta!

Ulsi Manja – ...jo vetëm këta që keni përballë, por edhe stafi juaj ndihmës, do të duhet të mbajnë një për një shënim pyetjet që bëjnë deputetët. Nuk e keni ju detyrim t’i mbani shënim të gjitha pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslim Murrizi – Në qoftë se ngecni, jua kujtoj përsëri, se për atë punë keni ardhur!

Ulsi Manja – Zoti Murrizi, jeni në të drejtën tuaj, mund të bëni 20 pyetje, stafi t’i mbajë shënim dhe në fund t’ia vërë në dispozicion Kryeprokurores. Në qoftë se do të duhet kohë pastaj për përgjigjen, është çështje tjetër.

Mund të vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbase, por kam përshtypjen se zoti Murrizi flet në emër të të gjithëve.

Myslim Murrizi – Zoti Sterkaj,

Gjatë shtjellimit të pyetjeve të mija mund të dalë edhe ndonjë pyetje që keni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Murrizi!

Zoti Sterkaj, e keni fjalën më pas.

Myslim Murrizi – Dakord.

Ajo që shikoj në korrupsionin pasiv të zyrtarëve të administratës është, se nga 32 mijë çështje vetëm 74 raste janë procedime penale në vitin 2018 për këtë lloj vepre penale që është shumë sensitive për qytetarët shqiptarë dhe për vetë publikun, sepse politika e ka në majë të gjuhës fjalën “hajdut” çdo ditë.

Ju thatë se ka pasur 23 procedime gjatë vitit 2017 dhe 24 procedime janë bërë gjatë vitit 2018 për korrupsion pasiv të zyrtarëve të lartë. Në 32 mijë çështje të jenë vetëm 24 procedime për hajdutillek?

3 procedime janë gjithsej për zyrtarët e lartë gjatë vitit 2017. Po aq paskan qenë edhe për vitin 2018. Ju thoni se është rritur numri i çështjeve në hetim. Nuk është se po shohim ndonjë gjë.

Këto 12 milionë euro të sekuestruara kanë marrë vendim të formës së prerë nga gjykata, janë konfiskuar, apo janë sekuestro nga ju? Pa përmendur vlerën në paund apo dollarë, që përmendni ju më pas.

Ju thoni se 256 subjekte janë kërkim gjatë vitit 2018. Ata janë në kërkim se nuk do t’i kapë policia apo janë në kërkim me të vërtetë? Mos janë si puna e Balilit? Kur do të dorëzohen këta, që të vinë me autobus? A përfshihen në këtë numër katër komisarët e policisë?

Ju thoni se janë 155 raste për ligjin e dekriminalizimit. 137 raste i ka prurë DAP-i, 5 KQZ-ja dhe 3 Kuvendi. Sa personel ka Prokuroria e Përgjithshme që merret me verifikimin e personave që janë objekt i ligjit për dekriminalizimin?

Ju keni tagër për të bërë hetim apo mjaftoheni thjesht me korrespondencën, letërporsitë nga vendet ku mund të jenë gjykuar personat përkatës?

Zonja Hysi tha se jeni për fletë lavdërimi, sepse nga 13 rekomandime të Kuvendit 12 i keni realizuar, njëren nuk e keni realizuar plotësisht, atë që ka të bëjë me vjedhjen, pra, sekuestrimin e pasurive të paligjshme dhe të parave të pista të hedhura në qarkullim në Shqipëri. Shpresojmë që këtë vit, megjithëse në këta 6 muaj, që ju kanë mbetur do t'u kushtoni rëndësi atyre çështjeve që shqetësojnë realisht shoqërinë dhe qytetarët shqiptarë.

Faleminderit!

Nëse ngecni për ndonjë pyetje, më thoni se mund ta përsëris.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Murrizi!

Ju i përmbledhët të gjitha pyetjet.

Edhe kolegu që kam në krah më tha se ia morët të gjitha pyetjet.

Zonja Marku, edhe unë bashkohem me mendimin e zotit Murrizi. Mund të filloni me përgjigjet e pyetjeve! Nëse ndonjë pyetje është për ndonjë sektor apo për ndonjë drejtori specifike, mund t'ia kaloni fjalën kolegëve që ju shoqërojnë. Fjala është për ju!

Arta Marku - Faleminderit, zoti Murrizi për pyetjet dhe për mënyrën se si i formuluat dhe i drejtuat ato!

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

Unë ju falënderova, nuk ju shava.

Fillojmë me çështjen më të ndjeshme, me 700 CD-të e pazbardhura. Pajtohem me pjesën e parë të komentit tuaj. Vërtet janë shumë dhe duket sikur prokuroria nuk ka bërë asnjë punë tjetër, por vetëm sa ka përgjuar zyrtarët dhe njerëzit.

Megjithatë, nuk pajtohem me pjesën tjetër të komentit. Në momentin që jam vënë në dijeni të kësaj problematike, unë kam ndërhyrë sipas kompetencave që më jep Kushtetuta dhe ligji.

Duhet t'ju them se kjo çështje ka filluar që në vitin 2016, është mbajtur në hetim për disa kohë dhe vetëm në shtator 2018 është parë kjo problematikë e CD-ve të pazbardhura, kur rastësisht një prokuror u çua në një prokurori tjetër dhe i dorëzoi çështjet që kishte nën hetim. Kjo çështje ka shumë volum, sepse janë shumë procedime të bashkuara në të, prandaj është ai numër i madh i CD-ve, sepse janë mbi 7 çështje të ardhura nga rrethe të ndryshme që do të hetojnë grupet e strukturuar kriminale me një numër të madh personash nën përgjim. Vërtet

duket një numër i lartë, por duke pasur parasysh volumin e çështjes është krejt normal. Është mbas gati 2 vjetësh nga regjistrimi i çështjes dhe pas më shumë se 1 viti nga zgjedhjet e vitit 2017, janë regjistruar emrat e parë të personave nën hetim për këtë çështje, që nuk kanë lidhje me korrupsionin në zgjedhje apo me këto vepra që lidhen me zgjedhjet, por janë thjesht për trafikim të narkotikëve dhe për grup të strukturuar kriminal. Kështu, siç ju thashë, në shtator 2018 është konstatuar ekzistenca e këtyre 700 CD-ve dhe DVD-ve të pazbardhura. Për këtë arsye i kam kërkuar drejtorisë së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pasi këtë mund t'ia kërkoj që të ngrejë një grup hetimor dhe t'i kushtohet sa më shpejt hetimit të kësaj çështjeje. Siç relatova pak më parë, janë 2 prokurorë dhe 11 oficerë të Policisë Gjyqësore që po merren me kryerjen e veprimeve hetimore, sepse aty nuk ka veprime hetimore, por ka vetëm përgjime të pazbardhura me transkriptimin e të gjitha CD-ve. Jam informuar që aty po punohet shumë dhe po ecet me ritme të shpejta. Besoj se së shpejti do të ketë një vendimmarrje. Për një pjesë të të pandehurve që janë të regjistruar aty, është ndarë çështja. Natyrisht, këta për të cilët është ndarë çështja, nuk kanë lidhje me zgjedhjet dhe janë dërguar për gjykim. Ata kanë lidhje me trafikimin e narkotikëve.

Në të njëjtën gjendje është edhe dosja tjetër nr. 184.

Pyetja tjetër juaja, lidhej me numrin e ulët të çështjeve të filluara kryesisht. Kjo varet nga këndvështrimi si e sheh këtë shifër. Për mendimin tim ky nuk është numër i ulët, megjithatë secili prokuror në Republikën e Shqipërisë mund të fillojë një çështje kryesisht. Tashmë, unë e relatova edhe pak më parë që nuk është atribut i prokurorisë aq më pak i Prokurorit të Përgjithshëm. Çdo prokuror vihet në dijeni të një fakti të bërë publik dhe ai mund të vijë të nesërmen në zyrë dhe ta regjistrojë çështjen.

Unë, si Prokuror e Përgjithshme në detyrë, në çdo rast që kam marrë dijeni për fakte të bëra publike (kam prova për këtë), kam dërguar shkresat përkatëse në prokuroritë që kishin kompetencë për hetimin e çështjeve për fakte të bëra publike dhe i kam orientuar që të verifikojnë rastin dhe të hetojnë sipas rastit.

Natyrisht, kjo ka qenë. Kaq kam pasur për detyrë të bëj.

Në lidhje me sekuestrot e pasurive, fakti që ato janë sekuestruar, nuk janë me vendim gjykatë por janë sekuestruar dhe çështjet janë në hetim. Kjo është gjendja dhe kështu unë jam e detyruar ta raportoj të tillë. Për konfiskimet që janë me vendim gjykatë, edhe ato i raportova gjatë fjalës sime.

Në lidhje me personat në kërkim, nuk preferoj të jap shifra dhe të bëj komente, pasi ajo është punë e policisë. Janë aty, por unë nuk dua t'i komentoj në asnjë lloj mënyre. Kapja e personave në kërkim është punë e policisë.

Për sa i përket strukturës që kemi në Prokurorinë e Përgjithshme për verifikimin e integritetit të personave që ushtrojnë funksione, është një staf prej 5 personash, një prokuror dhe 4 oficerë të Policisë Gjyqësore. Se çfarë detyrash kryejnë ata dhe se çfarë korrespondence mbajnë, është përcaktuar edhe në ligj, edhe në vendimin e Kuvendit. Për këtë arsye ata janë të detyruar t'i rrinë strikt asaj. Natyrisht, verifikohet çdo lloj fakti që del dhe dërgohen edhe letërporosi për marrjen e provave që janë jashtë Shqipërisë.

Mos kam harruar ndonjë pyetje?

Të lutem, ki mirësinë dhe m'i kujto!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për vetingun? Janë konfirmuar në detyrë 19 prokurorë, 21 prokurorë janë shkarkuar nga KPK-ja. 15 nga këta 21 janë ende në proces në KPA.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë kësaj pjese nuk mund t'i hyj, nuk mund të flas për këtë çështje. Pra, janë hedhur në short një numër shumë më i madh, rreth 118 prokurorë dhe drejtues të prokurorive dhe janë në proces. Këto janë shifrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më saktë, nuk arrita ta shënoja dot pyetjen, sepse nuk doja që të humbisja asnjë koment tuajin.

Ulsi Manja – Mund të vazhdoni me përgjigjen, ju lutem!

Arta Marku – Patjetër!

Unë nuk e pranoj komentin tuaj lidhur me përgjegjësitë e asnjë lloji, që më përkasin mua për zgjedhjen e këtij prokurori si anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Secili kandidat në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka bërë deklaratat kundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk ka qenë ish-anëtar i Sigurimit, që nuk është anëtar i Shërbimeve Sekrete apo që nuk ka konflikt interesi. Pra, jepen disa deklaratat, që janë kundrejt përgjegjësisë dhe ky është kuptimi i tyre.

Natyrisht, unë kam bërë më shumë se sa ishte bërë, pasi edhe kandidatët e tjerë ishin shpallur si të tillë, sepse nuk ishte bërë një verifikim në Autoritetin Dosjeve. Unë kam dërguar shkresë dhe është verifikuar secili prej tyre.

Në të njëjtën mënyrë, kam vepruar edhe me zotin Sheshi. Përgjigjja ka ardhur me vonesë dhe unë ia kam transmetuar KLP-së. Tani kjo shkresë ndodhet atje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Marku!

Fjalën për pyetje e ka kërkuar zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Në radhë të parë, dua të falënderoj zotin Murrizi, sepse gjithmonë na kujton në komision Paulin Prekën, Zef Dedën apo Tano Banushin! Ai e bën qëndrimin tonë më të lirshëm para Prokurores së Përgjithshme, para kolegëve, para kamerave, kështu që e falënderoj për humorin që na sjell në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Reprikën ma bëni jashtë.

Unë e mbështes relatoren, por kam një shqetësim, edhe nga kontaktet që kam pasur me banorë dhe avokatë të ndryshëm. Janë disa figura krimi, për të cilat në periudhën e vettingut prokuroria kërkon masën ekstreme: “arrest me burg”. Këto figura krimi nuk pengojnë as hetimin dhe as gjykatën që t’i ndjekë në gjendje të lirë dhe për të dhënë masa alternative, të cilat, realisht, ne i kemi parashikuar edhe në Kodin Penal.

Kam edhe një shqetësim tjetër, dhe këtë gjë dua ta ndaj me kolegët e Komisionit të Ligjeve dhe me kryetaren e Komisionit të Sigurisë. Me të drejtë për dhunën në familje janë vendosur masa të rënda penale. Mirëpo, në rast se gruaja e denoncon burrin se ka e dhunuar, oficerët e Policisë Gjyqësore marrin masa ekstreme dhe bëjnë arrestimin e burrit. Nesër gruaja paraqitet në polici dhe kërkon që ta nxjerrin nga burgu burrin e saj.

Unë dua të ilustroj një rast, duke i dhënë disa nota humorit. Një prokurore në Shkodër për dhunën në familje i ka propozuar titullarit të saj që, nëse një burrë ka konflikt me gruan e tij, nuk duhet ta rrahë ai gruan, por duhet ta rrahë kunati, sepse për kunatin mund të pushohet padia, kurse për burrin jo. A ka ardhur koha, zonja Vasilika, që të amendohet ky nen i ligjit? Edhe ju e kishit këtë shqetësim lidhur me masat e dënimit, në rastet kur ka pendesë në konfliktet familjare. A ka mundësi të amendohet ky nen i ligjit dhe të ketë një mirëkuptim apo një kompromis që për këto raste të hiqet masa e dënimit penal, sepse ne nuk fitojmë asgjë përveçse shkatërrojmë një familje? Në rastet ekstreme, kur nuk heq dorë askush, ligji le të funksionojë siç është, sepse, nëse gruaja ose burri heqin dorë nga një padi e tillë, ligji e detyron kryesisht dhe ata nuk kanë më asnjë mundësi për të hequr dorë nga padia, por do të vihen para përgjegjësisë penale. Nga ana njerëzore edhe prokurorët, edhe gjyqtarët, nuk kanë mundësi për ta bërë këtë, sepse shkelin ligjin. Pra, a mund ta bëjë këtë gjë Kuvendi i Shqipërisë dhe t’ua lehtësojmë punën prokurorëve dhe gjyqtarëve? A mund ta zbusim këtë nen, sepse nuk rregullojmë asgjë, përvese prishim shumë familje, duke e zbatuar ligjin me rigorizotet?

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Sterkaj!

Po, zonja Marku.

Arta Marku – Faleminderit!

Meqenëse ishin dy pyetje, unë do t'i përgjigjem pyetjes së parë, kurse pyetjes së dytë do t'i përgjigjet zonja Vasilika.

(Diskutime pa mikrofon.)

Për sa më takon mua, do t'i përgjigjem edhe kësaj pyetjeje.

Atëherë, për sa i përket ashpërsimit të masave të sigurimit, ka qenë një nga detyrat e përcaktuara në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë. Ashpërsimi i politikës penale për masat e sigurisë dhe për ato të dënimit janë bërë për disa vepra penale, që u përkasin krimit të organizuar, korrupsionit, dhunës në familje. Lidhur me dhunën në familje, rekomandimi ka qenë se duhej ashpërsuar qoftë masa e sigurimit, qoftë masa e dënimit. Kjo është bërë edhe për disa krime të tjera të parashikuara në rezolutë. Kështu që prokurorët nuk i detyron asgjë që të mos i dërgojnë provat dhe të gjitha nevojat e sigurimit, në mënyrë që ato të plotësohen më mirë. Prokurori i çështjes është ai që e vlerëson më mirë. Për më tepër është gjykata që i vlerëson provat pas prokurorit. Kështu që nëse edhe prokuroria, edhe gjykata dalin në të njëjtin konkluzion, unë mendoj se nuk ka vend për të diskutuar.

Për sa i përket dhunës në familje, është vërtet një problematikë e shoqërisë shqiptare. Kjo ka qenë arsyeja që për këto vepra janë parashikuar sanksione të rënda. Në vepra të tilla penale unë mendoj se është shumë efikase masa e arrestit në shtëpi me mbikëqyrje elektronike, por kjo gjë ka qenë e pamundur të aplikohet. Ndoshta kjo gjë do të kishte zbutur edhe gjakrat në familje.

Për sa i përket pjesës tjetër, i takon ligjvënësit nëse duhet bërë ndonjë ndryshim.

Paulin Sterkaj – A mund të sqaroj diçka?

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Marku!

Po, zoti Sterkaj.

Paulin Sterkaj – Qëllimi im nuk ishte të futesha në punën e prokurorisë dhe të gjykatës, por kam informacione lidhur me luftën ndaj krimit në vende të përparuara dhe demokratike. Në Shqipëri masa “arrest me burg”, kur nuk dëmton asnjë lloj procesi të hetimit, është ekstremisht i lartë. Për shembull, nëse ndodh një aksidentet me makinë dhe provat janë të qarta, sepse bëhet ekspertiza nga oficerët e Policisë Gjyqësore dhe ekspertët e fushës, atëherë pse duhet të merret masa “arrest me burg”, kur nuk ka asnjë lloj tendence? Pra, gjëja e parë që bëhet, është arrestimi i personit me faj apo pa faj. Pse duhet të arrestohet ky person, kur ekziston mundësia që të ndiqet në gjendje të lirë? Sepse ky njeri mund të mos e ketë shkelur asnjëherë ligjin në jetën e tij, por, fatkeqësisht, i ndodh një aksident për shkaqe dhe arsye të ndryshme. Atëherë, pse duhet të arrestohet ky person? Pse të mos ndiqet në gjendje të lirë? Pse duhet t'i japim vëmendje maksimale kësaj pune? Ne duhet të llogarisim edhe kostot që ka shteti në këto

raste. Kodi Penal është shumë i gjerë dhe çdo ditë policia dhe prokuroria punojnë, duke bërë arrestime pas arrestimesh dhe burgjet po mbushen. Pse të mos krijohet mundësia, që këtyre personave t'u jepen dënime alternative, të paktën për periudhën e hetimit? Një person mund të dënohet me burg kur e vendos gjykata dhe, normalisht, do të shkojë ta kryejë dënimin, por pse duhet bërë kjo gjë gjatë hetimit?! Pse duhet t'i mbushim burgjet, kur ka mundësi që të merren masa alternative?!

Unë mendoj, gjykoj dhe vlerësoj, se një pjesë e prokurorëve dhe gjyqtarëve janë nën presionin e vetingut dhe mund të thonë: “Pse duhet të rrezikoj unë sot dhe nesër të largohem nga vetingu, kur më mirë mund ta dënoj këtë person?” Prandaj, kjo gjë duhet parë dhe duhet gjykuar me kujdes.

Për mua është shqetësues fakti që Prokurores së Përgjithshme i janë hequr disa detyra. Unë mendoj se, kur emërojmë Prokurorin e Përgjithshëm, ai duhet të ketë detyra dhe funksione shumë më të mëdha, dhe jo siç thatë ju, që kjo apo ajo nuk është detyra juaj.

Pra, dikush duhet që të marrë një vendim të shpejt lidhur me këtë çështje, ose t'i orientojë këto probleme që po krijohen. Këto janë probleme sociale, por janë edhe probleme të mëdha ekonomike, sepse do t'i rëndojë taksapaguesit shqiptarë, ndërkohë që mundësia për t'i rregulluar problemet e dhunës në familje, është në dorën tonë. Unë do të marr përsipër një iniciativë, ta amendojmë, në njëfarë mënyre, që të kemi mundësi dhe ligji të ketë hapësira, që njerëzit, kur pendohen dhe bëjnë kompromis pas një sherri, pse të vuajnë me burg apo t'u bëhet mbikëqyrje elektronike, kur munden të bëjnë jetë normale me familjen, fëmijët dhe të mbyllet plaga në familje. Kaq kisha.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Sterkaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zonja Hysi, sepse kolegu Sterkaj e kishte edhe pyetje, edhe diskutim, sepse, në fund të fundit, përmbledhi një problematikë të shqetësimeve që ka edhe si deputet, por që janë çështje të realitetit të përditshëm në zonat tona.

Fjalën e ka zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtë vërejtje e kisha për ju që në fillim, sepse thatë: “kush e shtyp i pari”. Këtu nuk është “kush e shtyp i pari”, pasi prokuroria është organ i distancuar, i baraslarguar nga kahet politike dhe duhet të ishim më korrektë për t'ua dhënë më shpejt fjalën.

Ulsi Manja – Jam dakord.

Xhemal Qefalia – Kalojmë te çështja konkrete.

Zonja Prokurore, ju falënderoj për të gjithë ekspozenë që paraqitët, madje edhe për materialin analitik!

Për të mos humbur shumë kohë, do të adresoja dy pyetje.

Së pari, në vlerësimet e Ministrisë së Drejtësisë, e atakoi edhe relatorja Hysi, evidentohet një shkelje, një konstatim edhe nga ndërkombëtarët, që vazhdon ende të mbetet problem para dhe gjatë ardhjes suaj, që është mbajtja e evidencave dhe saktësia e tyre duke pasur një unifikim statistikor. Cila është arsyeja, vështirësia dhe çfarë kërkohet konkretisht për të mos qenë ky problem?

E dyta, zonja prokurore, ju kam ndjekur edhe në takime për analizat që keni zhvilluar në prokuroritë e rretheve, kryesisht në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ku keni qenë shumë kritike, dhe mirë keni bërë, për nxjerrjen dhe bërjen publike të materialeve hetimore. A mendoni, zonja Prokurore, që bërja publike ose marrja në një kontekst vetëm të shkëputur e disa përgjimeve ndikon jo vetëm në uljen e cilësisë së hetimit, por jep impakt negativ edhe te qytetarët që dëgjojnë apo të grupe të interesuara, të cilët i shfrytëzojnë për interesa dhe përfitime politike? A keni nisur një hetim, që këto përgjime të mos u shiten gazetarëve apo studiove televizive dhe të mbahet qëndrim i rreptë për cilindo që prish hetimet? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zonja Prokurore, është një pyetje e zotit Qefalia, që ka të bëjë me sekretin hetimor, me sa po kuptoj, dhe nëse ka procedime penale lidhur me këtë problematikë.

Arta Marku – Po filloj me përgjigjen e pyetjes së dytë.

Dua t'ju them se në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ka një hetim për nxjerrjen e sekretit hetimor për çështjet që janë bërë publike, për disa procesverbale përgjimesh.

A ndikon nxjerrja e sekretit në cilësinë e hetimit? Nuk mund të them se ndikon në cilësinë e hetimit, por ndikon në mjedisin ku operojnë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore. Pra, rritet presioni dhe bëhet pak më e vështirë puna, por nuk ndikon në cilësinë e hetimit.

Ka një hetim për nxjerrjen e sekretit në proces dhe në momentin që do të ketë një rezultat, do të bëhet publike nga prokuroria përkatëse.

Për sa u përket problemeve me statistikën, është vërtet një problem prej kohësh dhe nuk është krijuar tani. Në prokurori funksionon një sistem që ne e quajmë “*Case Management*”. Ky sistem është pjesërisht funksional, pasi është e nevojshme të bëhen reflektime të ndryshimeve që ka pësuar Kodi Penal. Kjo është në proces, ende nuk ka përfunduar dhe mendoj se ka ndikuar në cilësinë e statistikave.

Gjithashtu, një faktor tjetër që ndikon në prokuroritë përkatëse dhe në Prokurorinë e Përgjithshme është mungesa e personave të angazhuar vetëm me mbajtjen dhe përpunimin e statistikave nga fillimi i vitit deri në nxjerrjen dhe transmetimin e tyre në Prokurorinë e Përgjithshme. Duke mos pasur staf, këtë punë e bëjnë sekretarët e prokurorive ose angazhohet edhe kancelari, aty ku ka, por e bëjnë këtë plus punës së tyre të përditshme. Mendoj se edhe kjo ka pasur ndikimin e vet. Megjithatë, ne e kemi në vëmendje dhe po bëjmë ç'është e mundur që pasqyrimi të jetë sa më i saktë, sepse na intereson që puna të pasqyrohet dhe të vihet në dijeni publiku.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Prokurore!

Fjalën e ka zoti Alimadhi dhe më pas zoti Përmeti.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje.

Zonja, prokurore, kohët e fundit janë bërë ndalime të shumta ndaj protestuesve të Unazës së Re, por edhe protestuesve të tjerë. Opozita, me të drejtë, ka ngritur zërin. A janë ndalimet e tyre politike?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Nuk e di, zonja Marku, nëse pyetja e kolegut Alimadhi ...

Arta Marku – Po, në fakt, jam në dijeni të shumë ndalimeve që janë bërë dhe kam marrë një informacion për këtë. Çështjet janë në hetim në Prokurorinë e Tiranës nga prokurorët të ndryshëm. Ndalimet janë bërë nga policia, janë dërguar kërkesat në gjykatë nga prokurorët dhe një gjykatë i ka vlerësuar ato, ndaj, përderisa prokurori argumenton ekzistencën e kushteve dhe kritereve që parashikohen në ligj për masën e sigurisë, gjykata i ka vlerësuar ato, herë i ka miratuar kërkesat e prokurorit dhe herë jo, nuk ka vend komenti im nëse ndalimet janë politike.

Adriatik Alimadhi – Zoti kryetar, prandaj kishte një thelb pyetje, sepse shoqërimet i bën policia, dhe, duke parë që policia është, për të mos thënë politike, por realisht është, si është mendimi juaj, sepse ju bëni ndalimet.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Nuk dua të ndërhyj në këtë pjesë, por, e para, janë çështje në hetim.

E dyta, duke qenë se kanë kaluar në gjykatë, kam përshtypjen se cenojmë pavarësinë e një institucioni, siç është gjyqësori, ndaj, ju lutem, të fokusohemi te raportimi i vitit 2018.

Në këtë kuptim e ka kërkuar fjalën edhe kolegu Përmeti.

Adriatik Alimadhi – Pse e mbyllni kështu, zoti kryetar?

Ulsi Manja – Si?

Adriatik Alimadhi – Mos e mbyllni pa një përgjigje, duke parë se është e dobishme për opinionin publik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Në mos gabo, e morët përgjigjen.

Nëse Prokurorja ka përgjigje ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Nëse Prokurorja ka përgjigje, të vazhdojë.

Adriatik Alimadhi – Bëra një ndërhyrje, sepse ndalimin e kryen prokuroria me procedurë, ndërsa shoqërimin e kryen policia, ndaj bëhet ndarja politike në këtë rast, polici dhe prokurori.

Ulsi Manja – Dakord.

Po, zonja Marku.

Arta Marku – Ndalimi bëhet me iniciativë edhe nga Policia Gjyqësore, por mund të bëhet edhe me urdhër të prokurorit. Të gjitha rastet në fjalë janë me procesverbal ndalimi nga policia.

Policia është organ jopolitik, ka një drejtor të Përgjithshëm. Nuk jam këtu për mendime personale.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Përmeti.

Andi Përmeti – Zonja Prokurore, kam një pyetje që më lindi nga përgjigjja që i dhatë zotit Murrizi. Dëgjova disa fjali shqetësuese dhe dua të kem një konfirmim nga ju se si është gjendja sot.

Ju thatë: “Dosjet me 700 CD-i kanë fjetur atje dhe në rastin e transferimit të një prokurori, të cilit nuk ia di emrin, të them të vërtetën, u zbuluan që kjo dosje ishte në fjetje dhe ne filluam veprimtarinë”. Në mos gabo, ju thatë kështu. Nuk mund të pyes për ato që janë në hetim, por pyetja që më shqetëson është: a ka rrezik? A kemi garanci ne dhe publiku që të mos ketë dosje të tjera të fjetura, ku përfliten, përgjohen dhe ka emra politikanësh ose njerëz të rëndësishëm të këtij vendi, sot që po diskutojmë?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

Zonja Prokurore.

Arta Marku – Unë nuk besoj që të ketë prokuror të papërgjegjshëm deri në këtë pikë, për t’u përsëritur edhe një herë kjo që është bërë. Shpresoj të mos ketë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, e ka kërkuar fjalën për pyetje zonja Gjebrea.

Andi Përmeti – Po, por kam diçka të vogël.

Ulsi Manja – Po, zoti Përmeti.

Andi Përmeti – A ka masë kontrolli, apo është vetëm “shpresojmë të mos ketë”?

Arta Marku – Nuk ka një mënyrë, nuk kam një mekanizëm që të ma japë këtë të drejtë. Prokurori i Përgjithshëm, në bazë të një dispozite kalimtare, ka një kompetencë të reduktuar deri në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të bërë vetëm hetimin disiplinor të prokurorëve, pa pasur mundësi të kalojë në fazën tjetër, që është procedimi disiplinor, dhe vihet në lëvizje vetëm nëpërmjet ankesave të qytetarëve ose me fakte të bëra publike, siç është edhe rasti konkret. Prokurori i Përgjithshëm nuk ka kompetencë të bëjë kontrolle tematike, të bëjë kontrolle të dosjeve, sidomos kur janë në hetim, ndaj ju thashë “shpresoj”, sepse nuk kam mundësi, nuk kam mekanizëm që të bëj një kontroll të tillë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Marku!

Fjalën e ka zonja Gjebrea dhe më pas zoti Fino.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja Prokurore, për të gjithë raportin e detajuar dhe punën e bërë nga institucioni juaj!

Kam një pyetje për trafikimin e personave. Ju referuat këtu se ka një ulje të procedimeve penale. Konkretisht është neni 110 i Kodit Penal, “Për trafikimin e personave, nga 24 në 17”, sikurse ka edhe një ulje të çështjeve të trafikimit të të miturve, neni 128 i Kodit Penal. Në dijeninë time, çështjet e trafikimit të personave kanë kaluar në prokuroritë e rretheve gjyqësore përkatëse dhe nuk janë më atribut i Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ka lidhje çështja e uljeve të procedimeve penale me transferimin e përgjegjësisë në nivel rrethi, apo është një referim ndoshta jo i duhur nga ana e policisë?

Nga ana tjetër, pashë që hetimet apo vendimet nga gjykatat janë të ulëta. Në vitin 2018 kemi një rast me tre të pandehur, që është shumë e ulët, që tregon se ka një boshllëk. Do të sugjeroja që prokuroritë e rretheve të kenë patjetër trajnime masive, të njihen me këtë çështje, që është prioritet i qeverisë dhe duhet të punohet patjetër në mënyrë të vazhdueshme.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Zonja Prokurore, urdhëroni!

Arta Marku – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, më duhet t’ju them se të gjitha çështjet e trafikimeve vazhdojnë të jenë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Filluan të lëviznin para disa kohësh, të dërgoheshin për kompetencë në prokuroritë e rretheve, megjithatë, me iniciativën time dhe me përkrahjen e

kryetarit të Gjykatës së Lartë pati një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë, që njehsoi praktikën. Deri në krijimin e SPAKU-t dhe të Gjykatës Kundër Korrupsionit çështjet do të vazhdojnë të hetohen në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda, kështu që nuk ndikon transferimi i tyre në prokurori të tjera. Ky problem do të bëhet evident në momentin që do të ndodhë. Këtë e kemi thënë shpeshherë, e kemi diskutuar dhe ka nevojë për trajnime të prokurorëve nëpër rrethe për këto lloj veprash penale.

Ulsi Manja – Falemiderit!

Fjalën e ka zoti Fino dhe më pas zoti Braho.

Besoj se me zotin Braho do ta mbyllim seancën e pyetjeve.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

E falënderoj Prokuroren e Përgjithshme dhe gjithë stafin që është këtu!

Si qytetar, por edhe si deputet, më shqetëson një pyetje, për të cilën do të doja një përgjigje të sinqertë nga ju apo stafi juaj. Në raport me rezolutën jeni shumë në rregull. Siç e tha edhe relatorja, janë trajtuar të gjitha. Do të bëjmë rezolutë tjetër dhe do të punoni edhe gjatë vitit që vjen, por ajo që më shqetëson më shumë është: a ju përdorin? A përdoreni? Çfarë dua të them me këtë? Ka dalje të informacioneve nga Prokuroria e Përgjithshme në mënyrë skandaloze nga mediet apo nga portale të ndryshme. Problemi që unë shtroj për ju si institucioni që drejtoni: keni marrë ndonjë masë dhe keni pasur raste kur vërtet informacionet kanë dalë nga Prokuroria e Përgjithshme, raste të dosjeve sekrete që nuk duhet të dalin, të cilat janë bërë objekt i publikut, aq më tepër kur janë edhe politike?

Më lejoni t'ju them se ka dy mënyra për të dalë: një, kur ju përdorin dhe ju nuk e dini, padrejtësisht, dhe, natyrisht, duhet të merrni masë, por ka edhe mënyra të tjera, që mund ta përdorni vetveten, duke dhënë të dhëna me idenë për të marrë *feedback*-un që do të japë publiku, si do të reagojë publiku nga ato që do të dëgjojë. Nuk e kam personalisht për ju, por për institucionin, kuptohet. Për shembull, po t'i referohemi dosjes së famshme të përgjimeve, që e thanë edhe disa kolegë këtu, natyrisht që është fakt që ato kanë qenë hetime të tjera dhe për çështje të hetimeve të tjera kanë dalë edhe çështjen e përgjimeve dhe të zgjedhjeve. Konkretisht, besoni ju se këto përgjime kanë sot vlerë procedurale? Flas gjithmonë për shitblerjen e votës.

E dyta, a ka përgjegjësi për prokurorët e kohës, që nuk kanë vepruar në atë kohë dhe dalin me kaq vonesë? E gjithë kjo që sapo thashë ka të bëjë në njëfarë mënyre edhe me politikën e sotme, ku edhe ju jeni pjesë e politikës dhe nuk keni se si të shkëputeni, por nëse do të kishim vepruar dhe punuar me kohë dhe nëse do t'i kishim trajtuar gjërat me kohë, ndoshta nuk do të

ishim në këtë situatë politike që jemi sot. Po flas për ata që janë jashtë dhe jo për këto që janë brenda.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Marku.

Arta Marku – Informacionin nuk e ka nxjerrë Prokuroria e Përgjithshme, por ka rrjedhur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, sepse ata e kanë pasur çështjen. Ka një procedim penal, këtë e referova, për nxjerrjen e sekretit që është në hetim. Në momentin që do të ketë një vendim do të bëhet publik.

Natyrisht, unë nuk mund t’ju jap një përgjigje në lidhje me vlerën e përgjimeve, nëse transkriptohen kaq vonë dhe a kanë të njëjtën vlerë. Patjetër, nëse çështja ndiqet në kohë reale, pra në mënyrë preaktive, rezultatet janë shumë më të mira. Këtë e dimë të gjithë, sepse jemi juristë. E kam thënë edhe publikisht që mbajtja aq gjatë vetëm në përgjim dhe pa e ndjekur me veprime të tjera në terren, me vëzhgime, mendoj se mund ta dëmtojë çështjen, megjithatë CD-të po transkriptohen dhe t’ua lëmë prokurorëve të çështjes vendimmarrjen dhe vlerësimin e tyre.

Ulsi Manja – Po, zoti Braho e ka kërkuar fjalën për pyetje.

Spartak Braho – Edhe unë bashkohem me opinionin e përgjithshëm për rezultatet pozitive të veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, siç u relatua nga vetë Prokurorja e Përgjithshme dhe nga zonja Hysi.

Kam dy pyetje. Neni 184 i Kodit Penal parashikon shitblerjen e votës. Pse është gjykuar të hetohet nga Krimet e Rënda?

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Braho, e kam për saktësi këtë, bëhet fjalë për dosjen 184 apo për nenin 184 të Kodit Penal, sepse veprat e shitblerjes së votës parashikohen në një kreh të fundit, nëse nuk gaboj, nr. 330 e ca të Kodit Penal? 200 e ca...

Spartak Braho – Problemi është se hetohet nga Krimet e Rënda.

Ulsi Manja – E kuptoj problematikën, por i referoheni kësaj si dosje?

Spartak Braho – Po.

E dyta, që ta mbyllim dialogun bashkë, mos u vini shumë në siklet për këtë që do të them dhe do të kërkoj, por cili është opinionin juaj për një amnisti apo falje? Amnistia është pjesë e vullnetit politik të forcave politike dhe falja është obligim i Presidentit. Keni ndonjë opinion?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zonja Marku.

Arta Marku – Për pyetjen e parë, çështjet në fjalë po hetohen nga Krimet e Rënda, sepse janë të regjistruara për nenin 260 të Kodit Penal, që është kompetencën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Kështu është regjistruar nga prokurori i çështjes dhe regjistrimi është atribut i tij. Për këtë arsye hetohet aty. Nuk mund të jap një shpjegim tjetër më të dashur, më të pëlqyeshëm për ju.

Për pyetjen e dytë, nuk jam kundër amnistisë dhe faljes. Për amnistinë të ketë vullnet nga dikush që ka kompetencë dhe pjesë të funksionit për të marrë nisma ligjore, ndërsa për faljen, ai që ka kompetencën, ta ushtrojë kur plotësohen kriteret ligjore. Nuk kam asnjë kundërshtim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Marku!

Besoj se problemet u trajtuan deri diku, aq më tepër që kemi përpara edhe seancën plenare, ku Prokurorja e Përgjithshme në detyrë do të raportojë edhe para kolegëve të tjerë deputetë sërish për veprimtarinë e institucionit që ajo drejton për vitin 2018.

Në mbyllje, për procedurë, më lejoni të shpjegoj faktin që në mbledhjen e nesërme të komisionit, nëse nuk gabo, do të kemi edhe miratimin e një projektrezolute të Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e institucionit të prokurorisë për vitin 2019, e cila do të jetë shprehje e vullnetit të shumicës në Kuvend dhe që deri diku përputhet plotësisht edhe me rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2019 konkretisht në 6 fusha: në garantimin e pavarësisë së prokurorit, luftës kundër korrupsionit, luftës kundër krimit të organizuar, të drejtave të njeriut, bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar me autoritet e huaja, por me fokus të veçantë zbatimin e ligjit të dekriminalizimit, për të cilin me të drejtë shtruan pyetje disa kolegë si një nga prioritetet e reja që i ka ngarkuar ligji Prokurorisë së Përgjithshme.

Në vlerësimin e të dy komisioneve, seanca e sotme për raportimin e Prokurorores së Përgjithshme, si pjesë e kontrollit parlamentar të Kuvendit, kishte të bënte kryesisht me përmbushjen e rekomandimeve që ka lënë Kuvendi për institucionin që drejtoni ju për vitin 2018. Unë bashkohem edhe me mendimin e relatores, por edhe të disa kolegëve, që institucioni i prokurorisë, i cili tashmë ka marrë një rol të ri kushtetues, ku në fokus nuk është Prokurori i Përgjithshëm i fortë apo drejtuesi i fortë centralizimi i organit, por filozofia e të gjithë reformës sonë në sistemin e drejtësisë penale ka pasur vetëm një qëllim: prokurori i çështjes, lider i hetimit. Atë që deri më dje e bënte Prokurori i Përgjithshëm apo drejtuesit e prokurorive vendore, sot e bën gjykata dhe kjo është një arritje e reformës në sistemin e drejtësisë dhe në veçanti në sistemin e drejtësisë penale, por pse jo, siç e ka përcaktuar Kushtetuta dhe ligji,

Prokurori i Përgjithshëm, sot zonja Marku në detyrë, por Prokurori i Përgjithshëm që do të zgjidhet me mandat kushtetues, e ka detyrim të raportojë para Kuvendit për gjendjen e kriminalitetit edhe për shkak të faktit që ligji e ka ngarkuar si institucion që bën unifikimin e statistikave që vijnë nga prokuroritë vendore.

Nga 13 rekomandime që kishte lënë Kuvendi, 12 konsiderohen të përmbushura plotësisht, 1 konsiderohet në përmbushje e sipër. Me mirëkuptimin e kolegëve do të kërkoja që pika e rezolutës e papërmbushur plotësisht të rivendosjet në projektrezolutën e re. Do të kërkoja që pjesë të tekstit të projektrezolutës të ishin edhe shqetësimet që ngriti sot Prokurorja e Përgjithshme, që kanë të bëjnë me unifikimin e problematikave të statistikave, me ecurinë e procesit të vlerësimit të prokurorëve në raport me vetingun dhe adresimin si duhet të çështjeve të kriminalizimit. Unë këtu bie dakord me kolegun Murrizi, nëse në ligjin e dekriminalizimit ne kemi përcaktuar mekanizmat si vihet në lëvizje Prokurori i Përgjithshëm për të bërë verifikimin e zyrtarëve të lartë publikë, ndoshta është edhe ligjore që ne t'ua japim këtë mundësi, që ta bëjë institucioni që ju drejtoni, ta bëjë edhe kryesisht këtë çështje kur ka indikator apo materiale të bëra publike në medie, sepse për ne, si maxhorancë, është shumë e rëndësishme pasja e një mjedisi të pastër politik nga këto zyrtarë në administratën e lartë shtetërore.

Po ashtu, duhet të jetë pjesë e tekstit të projektrezolutës edhe adresimi i çështjeve, që kanë të bëjnë me hetimet për dosjet e pezulluara, të cilat kanë impakt për opinionin publik. Janë ngjarje shumë të bujshme në kohë, të cilat sot janë akoma të pazbardhura. Natyrisht që kjo nuk është në përgjegjësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, por duhet të shihet mundësia e adresimit nëpërmjet një udhëzimi me karakter të përgjithshëm, që prokuroritë vendore ta kenë në fokus zbardhjen e ngjarjeve të vjetra, sepse kam përshtypjen se zbulimi i tyre është garanci për parandalimin në të ardhmen.

Dua ta mbyll me atë që sollën në vëmendje së fundi kolegët Fino dhe Braho, për zbatimin e Kodit të Procedurës Penale nga prokurorët e hetimit, që ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sekretit hetimor për çështjet në hetim.

Natyrisht, mes juristëve mund të ketë debate të ndryshme se sa ndikon në cilësinë e hetimit nxjerrja e materialeve të tilla në publik, sepse përgjimi, gjithsesi, ngelet mjet i kërkimit të provës, jo provë. Por për ngarkesat emocionale që shkarkojnë këto në opinionin publik, do t'i kërkoj relatores dhe stafit që në një nga rekomandimet e Kuvendit të nënvizohet respektimi i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga çdo prokuror. Ky është një detyrim ligjor, që shkakton përgjegjësi penale. Ky mesazh, nëpërmjet një udhëzimi, duhet të përcillet poshtë, te prokurorët e hetimit dhe tek të gjithë hetuesit e prokurorive vendore. Këtë ua detyron ligji.

Ndoshta mund ta keni nxjerrë këtë udhëzim, por unë nuk jam në dijeni të këtij fakti. Nëse udhëzimi është nxjerrë, duhet t'i bëhet transparenca dhe publiciteti i duhur. Në faqen e prokurorisë mund të jetë botuar, por duhet të rinëvizohet. Nëse nuk ka dalë, duhet të jetë...

Vasilika Hysi – Ka dalë.

Ulsi Manja – Kolegia Hysi thotë se ka dalë.

E fundit ka të bëjë me një shqetësim, që e ngriti kolegu Sterkaj, për aplikimin e masave alternative nga gjykata.

Natyrisht, kjo është çështje e diskrecionit të gjykatës, sipas Kodit të Procedurës Penale, por u takon edhe agjencive të tjera (e kam fjalën për Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimin e Provës, Prokurorinë, Policinë e Shtetit) të krijojnë, le të themi, infrastrukturën e duhur për aplikimin e ligjit të mbikëqyrjes elektronike. Nëse do të merren ose jo në konsideratë, kjo është çështje e gjyqësorit, por ne nuk mund t'ua mohojmë sot gjyqtarëve aplikimin e një mase të tillë për shkak të mungesës së infrastrukturës, që ka të bëjë me mbikëqyrjen elektronike.

Shumë faleminderit për raportimin e plotë dhe shterues, zonja Prokurore e Përgjithshme në detyrë! Faleminderit edhe stafit që ju shoqëron, se nuk po i përmend me radhë!

Faleminderit medieve për mënyrën korrekte të transmetimit, ndoshta edhe *live*, të kësaj seance të përbashkët dëgjimore me Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Kam edhe një falënderim për të gjithë kolegët e mi deputetë, pa përjashtim, për angazhimin dhe impenjimin në debatin e sotëm në këtë seancë dëgjimore me Prokuroren e Përgjithshme! Ky impenjim dhe angazhim tregon qartë për vëmendjen e shtuar që kemi ne, jo vetëm si deputetë, si Kuvend, por edhe opinioni publik, për këtë agjenci shumë të rëndësishme të zbatimit të ligjit në Shqipëri, nga e cila presim shumë, presim edhe ndëshkimin e zyrtarëve të lartë, që kanë lidhje me korrupsionin.

Shpresojmë që organet e reja apo organet e posaçme të luftës kundër korrupsionit (këtu e kam fjalën për SPAK-un) të krijohen sa më shpejt, sepse, në fund të fundit, çështja e luftës kundër korrupsionit në radhët e zyrtarëve, por jo vetëm, për shumë e shumë vite e ka mbajtur shoqërinë shqiptare në këtë standard demokracie ku jemi sot.

Shumë faleminderit!

Ditë të mbarë!

